



AGJENCIA E SIGURIMIT TË CILËSISË NË ARSIMIN E LARTË

## RAPORTI I VLERËSIMIT TË JASHTËM

Programi i Studimit të Ciklit të Parë Bachelor në  
“Inxhinieri Ndërtimi”  
i  
Institucionit të Arsimit të Lartë “UNIVERSITETI POLIS”

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm:

1. Prof. Asoc. Dr. Igli Kondi

2. Prof. Asoc. Dr. Erion Luga

Korrik /2022

**TABELA PËRMBLEDHËSE E TË DHËNAVE TË PROGRAMIT TË STUDIMIT**  
**Për programin e studimit të ciklit të parë “Bachelor” në “Inxhinieri Ndërtimi”**

Nr.		
1	IAL aplikues:	Universiteti Polis (UP)
2	Njësia bazë që e ofron:	Departamenti Arkitekturë dhe Inxhinieri (DAI)
3	Emërtimi i programit të studimit:	Bachelor në Inxhinieri Ndërtimi
4	Urdhëri/VKM i licencimit:	VKM Nr. 698, datë 11.10.2006
5	Urdhëri/VKM i riorganizimit:	VKM Nr. 746, datë 24.10.2012
6	Forma e regjistrimit të diplomës:	Urdhër 155, datë 10.09.2020
7	Urdhëri/VBA i akreditimit të parë:	Urdhër Nr. 227, datë 22.07.2009
8	Cikli i studimit:	Inxhinieri Ndërtimi
9	Kohëzgjatja e programit të studimit:	3 (tre) vite akademikë
10	Kreditet në total (ECTS):	180 (njëqind e tetëdhjetë)
11	Forma e studimit:	Me kohë të plotë
12	Gjuha (shqip/tjetër):	Shqip
13	Programi ofrohet në bashkëpunim me institucione të tjera:	Jo
14	Diplomë e përbashkët (shëno emërtimin):	Jo
15	Diplomë e dyfishtë (shëno emërtimin):	Jo
16	Niveli në kornizën kombëtare të kualifikimeve:	Niveli 6
17	Stafi akademik PAE/PAK për programin e studimit:	18/4
18	Numri i studentëve:	172
19	Komente / të tjera:	Jo

## **PËRMBLEDHJE E VLERËSIMIT TË JASHTËM**

### **Përshkrim përmbledhës**

Programi i Studimit **Bachelor në “Inxhinieri Ndërtimi”** ofrohet nga Fakulteti i Arkitekturës dhe Dizajnit, Universiteti POLIS, Departamenti Arkitekturë dhe Inxhinieri.

Me **VKM nr. 315, datë 21.07.2014**, “Për hapjen e programit të studimit të ciklit të parë “Bachelor” pranë fakultetit “Arkitekturë dhe Dizajn” në universitetin “POLIS”, i është nënshtruar për herë të parë procesit të akreditimit në vitin 2016 duke u akredituar me **Urdhër të Ministrit të Arsimit dhe Shkencës Nr. 270, datë 20.05.2016**.

Akreditimi periodik IAL Universiteti “POLIS” me vendimin e Bordit të Akreditimit të ASCAL nr 113 të datës 15.12.2017 është për 6 vite (14.12.2023) dhe organizohet me njësitë kryesore:

#### **Fakulteti Arkitekturë dhe Dizajn**

Departamenti Art dhe Dizajn

Departamenti Arkitekturë dhe Inxhinieri

Qendra Kërkimore në Arkitekturë, Inxhinieri dhe Dizajn

#### **Fakulteti Planifikim, Mjedis dhe Menaxhim Urban**

Departamenti Planifikim dhe Menaxhim Urban

Departamenti i Mjedisit

Qendra Kërkimore e Qëndrueshmërisë

#### **Fakulteti për Kërkim dhe Zhvillim**


Departamenti i Kërkimit Shkencor

Departamenti i Kërkimit të Aplikuar

Qendra e Burimeve dhe Informacionit

#### **Qendra Studimore Ndërdisciplinore Kërkimore e Inovacionit**


Programi i studimit **Bachelor në “Inxhinieri Ndërtimi”** organizohet nga Departamenti Arkitekturë dhe Inxhinieri i ndihmuar edhe nga Departamentet tjera të njëjsteve tjera akademike të IAL-së, përkatësisht nga Fakulteti Arkitekturë dhe Dizajn i filluar nga viti 2013-2014 me 16 studentë të regjistruar, ndërsa në vitin 2021-2022 janë 172 studentë aktivë.



## SHKALLA E PËRMBUSHJES SË REKOMANDIMEVE NGA AKREDITIMI I FUNDIT

Mbështetur ne vendim nr. 270, datë 20.05.2016 për akreditimin periodik të programit të studimit të ciklit të parë, programi Bachelor në "Inxhinieri Ndërtimi" të Universitetit "Polis" si dhe *Aneksi Nr. 18*, nuk përmban asnjë rekomandim. Ndërsa IAL pranon se ka të evidentuar disa sugjerime nga ekspertët e jashtëm të cilat mund te numërohen si:

- Laboratori i testimit te materialeve dhe analizave sizmike, duke ngritur disa laboratorë të posaçëm
- Hartimi i dispensave për secilën lëndë mësimore, ku IAL përveç të tjerash ka abonim në dy biblioteka e-library (JSTORE dhe EBSCO)
- Bashkëpunimet akademike, IAL ka projekte ndërkombëtare si Erasmus+, Mobilitetet e studentëve, programet e studimeve të ciklit të tretë të studimeve *Aneksi Nr.34*.
- Sistemi i tutoriatit, për të cilin IAL reflekton në organizim të punës me studentët.



## Përshkrimi i procesit të vlerësimit të jashtëm

ASCAL ka përcaktuar kohën dhe grupet e vlerësimit të jashtëm për vlerësimin e programit të studimit të ciklit të parë Bachelor në “Inxhinieri Ndërtimi”.

Bazuar ne VKM nr. 109 date 15.02.2017, me vendimin nr.prot 27 te datës 14.01.2022, ASCAL përcakton grupin e ekspertëve për vlerësim në përbëje nga:

- Prof. Asoc. Dr. Igli Kondi

- Prof. Asoc. Dr. Erion Luga

Gjatë gjithë procedurës GVJ është asistuar nga Koordinatori Teknik i ASCAL, MSc. Juna Mengri.

Përmes sistemit të ASCAL, ekspertëve të jashtëm iu vu në dispozicion i gjithë dokumentacioni i dorëzuar nga institucioni për vlerësimin e programit të studimit.

Pas shqyrtimit të dokumentacionit ekspertët përgatitën draft raportin dhe hartuan një gamë pyetjesh të cilat ndihmuan në qartësimin e disa pikave dhe problematikave të këtij raporti.

Gjatë vizitës së kryer në Universitetin POLIS, në datat 20-21 Prill 2022, u zhvilluan një sërë takimesh mes grupit të vlerësimit të jashtëm dhe përfaqësuesve të Universitetit POLIS. Këto takime u shoqëruan me diskutime intensive dhe në përfundim të tyre GVJ hartoi raportin e mëposhtëm, i cili paraqet mendimet e ekspertëve të jashtëm mbi këtë program studimi.

Më datë 30.06.2022 përmes sistemit AMS, Universiteti Polis është njohur me Draft-Raportin e vlerësimit të jashtëm për këtë program studimi dhe me shkresë zyrtare Nr. Prot. 43/8, datë 01.07.2022.

Më datë 06.07.2022, Universiteti Polios nëpërmjet sistemit AMS dhe me shkresë me Nr. Prot. 506, datë 05.07.2022, shpreh dakordësinë me përmbajtjen e draftit.

Sa më sipër, Draft- Raporti kthehet në Raport përfundimtar.

## Vlerësimi i Programit të Studimit të Ciklit të Parë Bachelor në “Inxhinieri Ndërtimi”

### I. OFRIMI, ORGANIZIMI DHE DREJTIMI I PROGRAMEVE TË STUDIMIT BACHELOR

<b>Standardi I.1</b> <b>Institucioni i arsimit të lartë ofron programe studimi në përputhje me misionin dhe qëllimin e tij e që synojnë ruajtjen e interesave dhe vlerave kombëtare.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni ofron programe studimi që nuk bien ndesh me interesat kombëtare.	Nëpërmjet konsultimit me dokumentacionin bazë të dosjes së vetëvlerësimit (DVV) si dhe gjetjeve gjatë vizitës në institucion, GVJ konkludon që programi i studimit Bachelor në “Inxhinieri Ndërtimi” ofron një kurrikulë mësimore konkurruese, programe lëndësh të përditësuara e me nivel pedagogjik e shkencor të mirëasimilueshëm, infrastrukturë e logjistike të përshtatshme dhe cilësi produkti të kërkuar në tregun e punës dhe të mirëpritur nga nivelet e tjera të studimit profesional. Cilësia e këtij produkti dhe angazhimi i tij në përdorimin e njohurive të fituara është në përputhje të plotë me interesin kombëtar për të ndërtuar sa më shumë, sa më mirë e sa më lirë. Programi i studimit Bachelor në “Inxhinieri Ndërtimi” është konceptuar në përputhje me vizionin e Universitetit Polis (UP), sipas të cilit arsimi i lartë ka një rol parësor e unik në përmirësimin e kohezionit social të një vendi dhe inxhinieria e ndërtimit, mbi të gjitha, është pjesë e pandarë e zhvillimit shoqëror dhe ekonomik të një vendi. <i>(Ref: DVV (RVBP))</i>
<b>Kriteri 2.</b> Programet e studimeve synojnë ruajtjen dhe konsolidimin e vlerave akademike e kulturore kombëtare.	Programi i studimit (PS) Bachelor në “Inxhinieri Ndërtimi” ka funksionuar si i tillë qysh nga viti akademik 2014 – 2015. Produkti i tij tashmë ka identitet të qartë dhe është integruar plotësisht në komunitetin e profesionistëve në fushën e ndërtimit. Si i tillë, referuar RVB dhe planeve strategjike të UP, ai ka dëshmuar se është në vazhden e ruajtjes dhe konsolidimit të vlerave akademike e shkencore. <i>(Ref: DVV (RVBP))</i>
<b>Kriteri 3.</b> Programet e studimeve hartohen dhe ofrohen në përputhje me qëllimet dhe misionin e institucionit, si dhe fushën e	GVJ konsultoi jo vetëm kurrikulën aktuale dhe silabuset e lëndëve, por edhe planet strategjike të institucionit dhe njësisë bazë. U gjet që ky PS është konkures në kuadrin kombëtar dhe ka ambicien të mbetet i tillë në fushën e veprimtarisë. Në këtë perspektivë duket qartë që ky PS

veprimtarisë.	zhvillohet në përputhje me qëllimin dhe misionin e institucionit.		
<b>Kriteri 4.</b> Programet e studimeve hartohen dhe ofrohen në përputhje dhe për të nxitur zhvillimin ekonomik lokal dhe/ose kombëtar.	Referuar kurrikulës së këtij programi studimi, konstatohet që ajo është hartuar e tillë që të nxjerrë produkt sa më cilësor, ndërsa referuar angazhimit të produktit të këtij PS konstatohet, që ai ka kompetencën e duhur për të nxitur zhvillimin ekonomik kudo ku ai angazhohet. (Ref: Aneks 14 dhe Aneks 42).		
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
			<b>X</b>

<b>Standardi I.2</b>	
<b>Programet e studimit janë në përputhje me strategjinë e zhvillimit, statutin dhe aktet e tjera rregullatore të institucionit të arsimit të lartë dhe fushat akademike të tij.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni përcakton qartë se programet e studimit hartohen dhe ofrohen në përshtatje dhe në zbatim të strategjisë për zhvillim të vetë institucionit.	Referuar planit strategjik të UP, për periudhën 2021 – 2026, lidhur me vizionin, prioritetet dhe objektivat strategjike, GVJ konstaton që PS Bachelor në “Inxhinieri Ndërtimi” ofrohet në përshtatje dhe në zbatim të strategjisë për zhvillimin e institucionit.
<b>Kriteri 2.</b> Statuti dhe rregullorja e institucionit përcaktojnë qartë drejtimit prioritar akademike të tij dhe demonstrojnë se programet e studimit hartohen dhe ofrohen në përputhje dhe në zbatim të këtyre të fundit.	GVJ konsultoi paraprakisht statutin e institucionit, rregulloren e përgjithshme të tij, rregulloren e njësisë kryesore, rregulloren e programit të studimit Bachelor në “Inxhinieri Ndërtimi”. Statuti është miratuar në vitin 2016 dhe është miratuar nga ministria përgjegjëse për arsimin e lartë në 2017. Programi i studimit (PS) është çelur në vitin akademik 2014 – 2015. Programi i studimit (PS) Bachelor në “Inxhinieri Ndërtimi” është konceptuar në përputhje me frymën e statutit të institucionit, rregulloren e tij, si edhe rregulloren e njësisë bazë për këtë program studimi. Zbatimi i përcaktimeve statutores dhe rregullore të institucionit konstatohet edhe në standartizimin e mënyrës së hartimit të dokumentacionit të njësisë bazë.
<b>Kriteri 3.</b> Emërtimi, organizimi, struktura dhe përmbajtja e programeve të studimit ofrohen në përputhje me fushat e drejtimit akademike të institucionit.	Universiteti Polis, si një institucion jopublik i arsimit të lartë, është person juridik, krijuar me vendim gjykate Nr. 35386, datë 04.04.2006. UP është licencuar bazuar në vendimin e Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë, Nr. 698, datë 11.10.2006. Akreditimi i parë i institucional është kryer bazuar në urdhërin Nr. 227, datë 22.07.2009 të ministrit të arsimit dhe shkencës, duke fituar statusin “Universitet” me VKM Nr.

	746, datë 24.10.2012. Në këtë kuadër GVJ, referuar dokumentave të DVV, konstaton që PS Bachelor në “Inxhinieri Ndërtimi”, i cili ofrohet nga Departamenti Arkitekturë dhe Inxhinieri, si njësi bazë, dhe Fakulteti Arkitekturë dhe Dizajn, si njësi kryesore, është në përputhje me fushat dhe drejtimet akademike të UP. (Ref: DVV)		
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
			X

<b>Standardi I.3</b>	
<b>Programet e studimeve synojnë të plotësojnë nevojat e tregut të punës dhe ofrohen në përputhje me kërkesat e tij.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Programet e studimeve kanë objektiva të përcaktuar qartë për formimin e studentëve në këto programe, të cilët përfshijnë dijet, aftësitë dhe kompetencat profesionale që duhet të fitojnë studentët në përfundim të programit të studimit dhe që karakterizojnë profilin e programit.	Referuar RVB-së si dhe gjetjeve gjatë vizitës në institucion, GVJ konstaton që programi i studimit Bachelor në “Inxhinieri Ndërtimi” ka objektiva të përcaktuara qartë për formimin profesional të studentëve duke i aftësuar ata në zbatimin e njohurive të marra në të gjitha lëndët e kurrikulës, duke nxitur pasionin për t’i thelluar njohuritë në ciklet e tjera të studimeve, duke formuar koncepte të qarta për dobinë e punës në ekip, duke rritur përgjegjësinë në vlerësimin e rezultateve të analizave laboratorike, duke njohur konkurrencën në tregun e punës, dhe duke i ndërgjegjësuar për rëndësinë dhe dobinë e produkteve të tyre.  Referuar objektivave të përcaktuara si koncepte themelore në syllabysen e lëndëve, konstatohet që në këtë PS synohet t’u jepen studentëve dije, aftësi dhe kompetenca profesionale që karakterizojnë profilin e tij si: <ol style="list-style-type: none"> <li>1. aftësi për të zbatuar njohuri të matematikës, disiplinave shkencore dhe inxhinierike;</li> <li>2. aftësi për të hartuar një sistem përbërës ose proces në përmbushje të nevojave të dëshiruara;</li> <li>3. aftësi për të funksionuar në ekipe multidisiplinare ;</li> <li>4. aftësi për të identifikuar, formuluar dhe zgjidhur probleme inxhinierike;</li> <li>5. përceptim të përgjegjësisë profesionale dhe etike;</li> <li>6. aftësi për të komunikuar në mënyrë efektive;</li> <li>7. edukim për të kuptuar ndikimin e zgjidhjeve</li> </ol>




	<p>inxhinierike në një kontekst global dhe shoqëror;</p> <p>8. njohje të nevojës dhe disponim të aftesisë për t'u përfshirë në mesimnxënie përgjatë gjithë jetës;</p> <p>9. përditësim të njohurive bashkëkohore;</p> <p>10. aftësi për të përdorur teknikat dhe mjetet moderne inxhipierike të nevojshme për punën si inxhinierë etj.</p> <p><i>Referencë: Dokumentet e DVV (Tabela përmbledhëse e anekseve, Modeli i silabuseve, elementët sipas VKM 41/2018), Protokoll i takimeve gjatë vizitës në institucion)</i></p>						
<p><b>Kriteri 2.</b> Institucioni kryen studime mbi tregun lokal e ndërkombëtar të punës për programet e studimit që ofron, përpara hapjes së tij, pas daljes së studentëve dhe në mënyrë periodike. Këto studime duhet të përfshijnë: të dhëna nga komunikimi zyrtar me punëdhënësit e fushës, kërkesat dhe nevojat e tyre, mundësitë e punësimit të studentëve, të dhëna mbi punësimin real të studentëve të diplomuar dhe zhvillimet e pritshme në sektorin përkatës.</p>	<p>GVJ konstatoi që institucioni kryen studime periodike për tregun e punës. Këto studime sigurojnë efektshmërinë dhe jetëgjatësinë e PS. Për këtë funksionon zyra e mbështetjes së studentëve dhe e këshillimit të karrierës. Është krijuar në bazë elektronike të dhënash e cila përditësohet në vazhdimësi. Mbi këtë bazë të dhënash orientohen studentët për profilizimin e karrierës së tyre, duke lehtësuar punësimin dhe përfshirjen në tregun e punës.</p> <p><i>Referencë: DVV, Protokoll i takimeve gjatë vizitës në institucion</i></p>						
<p><b>Kriteri 3.</b> Objektivat formues, struktura dhe përmbajtja e programeve të studimit, rezultatet e pritshme të të nxënësve, garantojnë përfundimin e dijes, aftësisë, shkathtësisë e kompetencave që u përgjigjen nevojave të tregut të punës dhe lehtësojnë punësimin e studentëve.</p>	<p>Në aspektin formues objektivat e PS Bachelor në "Inxhinieri Ndërtimi" synojnë t'u sigurojnë studentëve dhe të diplomuarve dije profesionale, zotësi në përdorimin e tyre, kuptim dhe zgjidhje të problemeve në ndërtim, dëshirë dhe ambicje për të njohur e përvetësuar informacionin bashkëkohor etj. Realizimin e këtyre objektivave GVJ e konstaton të arrirë bazuar në informacionet që siguroi për produktin e deritanishëm, si dhe duke analizuar kurrikulën ekzistuese, syllabuset e lëndëve të veçanta, në kategorizimin e tyre A, B, C, D dhe E, duke shqyrtuar planet strategjike të zhvillimit si dhe duke parë angazhimin konkret si të personelit akademik e ndihmës ashtu edhe të studentëve.</p>						
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<table border="1"> <thead> <tr> <th>Përmbushet pjesërisht</th> <th>Përmbushet kryesisht</th> <th>Përmbushet plotësisht</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td></td> <td></td> <td>X</td> </tr> </tbody> </table>	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht			X
Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht					
		X					

**Standardi I.4**

**Programet e studimit janë në përputhje me fushën akademike të njësisë kryesore dhe**

**bazë përgjegjëse për programin e studimit në institucion.**

<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni demonstroi se ka përvojën, kapacitetet dhe burimet e duhura në fushën akademike specifike për ofrimin e një programi studimi në një fushë të caktuar.</p>	<p>Lidhur me plotësimin e këtij kriteri, GVJ iu referua gjetjeve në RVB si dhe informacioneve të marra gjatë vizitës në institucion. Nisur nga këto, GVJ konstaton që institucioni i ka burimet, kapacitetet dhe përvojën e duhur për të ofruar programin e studimit Bachelor në "Inxhinieri Ndërtimi". Në RVB burimet përvoja dhe kapacitetet e UP paraqiten si më poshtë:</p> <p><u>Burimet Infrastrukturore:</u> Mjedise për studentët (auditorë, klasa për leksione dhe seminare, laboratorë të eficiencës së energjisë, laboratorë informatike, bibliotekë, mjedise për fotokopjim/librari, zyra për informimin e studentëve, mjedise sociale dhe sportive); Mjedise për stafin (zyra, sallat e mbledhjeve, mjedise për personelin e shërbimit, mjedise çlodhëse).</p> <p><u>Shërbime IT</u></p> <p><u>Burimet njerëzore:</u> Numri i duhur i anëtarëve të stafit akademik, me një përvojë të përshtatshme në disiplinat specifike të inxhinierisë së ndërtimit.</p> <p>Programi i studimit ofrohet nga Fakulteti Arkitekturë dhe Dizajn (FAD). Në strukturën përbërëse të tij përfshihet edhe Departamenti Arkitekturë dhe Inxhinieri (DAI), përgjegjës për programin e studimit.</p> <p>Personeli Akademik Efektiv (PAE) në rang fakulteti (37 pedagogë) përbëhet nga:</p> <ul style="list-style-type: none"><li>- 2 Profesorë Dr.</li><li>- 0 Profesorë të Asociuar Dr.</li><li>- 13 Doktorë/PhD</li><li>- 8 Doktorë në proces</li><li>- 12 MSc.</li></ul> <p>Personeli Akademik me Kontratë (PAK) në rang fakulteti (11 pedagogë) përbëhet nga:</p> <ul style="list-style-type: none"><li>- 0 Profesorë Dr.</li><li>- 0 Profesorë të Asociuar Dr.</li><li>- 3 Doktorë/PhD</li><li>- 0 Doktorë në proces</li><li>- 8 MSc.</li></ul> <p>Personeli Akademik Efektiv (PAE) në rang departamenti, përgjegjës për programin e studimit (21 pedagogë),</p>



	<p>përbëhet nga:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- 1 Profesor Dr.</li> <li>- 0 Profesorë të Asociuar Dr.</li> <li>- 8 Doktorë/PhD</li> <li>- 5 Doktorë në proces</li> <li>- 4 MSc</li> </ul> <p>Personeli Akademik me Kontratë (PAK) në rang departamenti, përgjegjës për programin e studimit (4 pedagogë), përbëhet nga:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- 0 Profesorë Dr.</li> <li>- 0 Profesorë të Asociuar Dr.</li> <li>- 0 Doktorë/PhD</li> <li>- 0 Doktorë në proces</li> <li>- 4 MSc</li> </ul> <p>Gjatë vizitës në institucion GVJ konstaton ekzistencën dhe përdorimin me efektivitet si të përvojës ashtu edhe burimeve e kapaciteteve.</p> <p><i>Referencë: Tabelat përmbledhëse, Bachelor në "Inxhinieri ndërtimi"</i></p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit duhet të jetë në përputhje me fushën akademike e kërkimore të njësisë kryesore, përgjegjëse për programin e studimit, sipas klasifikimit/kodifikimit të programeve të studimit sipas direktivave dhe udhëzimeve kombëtare e evropiane.</p>	<p>GVJ konstatoi që fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit Bachelor në "Inxhinieri Ndërtimi" është në përputhje me fushën kërkimore-shkencore dhe akademike të FAD, si edhe të DAI.</p> <p>Është kryer kodifikimi i brendshëm i lëndëve apo i programeve të studimit, pasi kodifikimi kombëtar i programeve të studimit, siç parashikohet nga dispozitat e nenit 86 të ligjit Nr. 80/2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë" VKM nr. 310 dt 11.05.2022 për kodifikimin.</p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit duhet të jetë në përputhje me fushën akademike e kërkimore të njësisë bazë, përgjegjëse për programin e studimit, sipas klasifikimit/kodifikimit të programeve të studimit sipas direktivave dhe udhëzimeve kombëtare e evropiane. Në rastet e programeve ndërdisiplinore, të paktën një nga njësitë bashkëpunuese duhet ta sigurojë këtë përputhje.</p>	<p>Lidhur me plotësimin e këtij kriteri GVJ iu referua gjetjes në RVB ku shkruhet se programi i studimit Bachelor në "Inxhinieri Ndërtimi" ofrohet nga Departamenti Arkitekturë dhe Inxhinieri dhe i cili, sipas ligjit të arsimit të lartë, është njësi bazë e Fakultetit Arkitekturë dhe Dizajn. Departamenti ka të drejtë të japë grada universitare, duke ofruar trajnime akademike për studentët dhe promovon kërkime shkencore në nivelin më të lartë. Departamenti ofron programe studimi në nivelin Bachelor dhe Master. Departamenti mirëpret studentët që dëshirojnë të studiojnë për programet e studimit në</p>


	<p>përputhje me kërkesat e legjislacionit të arsimit të lartë në Shqipëri, si dhe me procesin Evropian të Bolonjës dhe Sistemin Evropian të Transferimit të Krediteve.</p> <p>Fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit Bachelor në “Inxhinieri Ndërtimi” është në përputhje me fushën kërkimore dhe akademike të Departamentit Arkitekturë dhe Inxhinieri. Në planin strategjik të këtij departamenti GVJ gjeti objektivat dhe synimet e departamentit lidhur me zhvillimin e PS Bachelor në “Inxhinieri Ndërtimi”. Në kushtet e mungesës së kodifikimit kombëtar të programeve të studimit, siç parashikohet nga dispozitat e nenit 86 të ligjit Nr. 80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë” institucioni ka kryer kodifikimin e brendshëm të programeve të studimit dhe lëndëve në përputhje me fushën e veçantë të studimit.</p>			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>		<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				<b>X</b>

### Standardi I.5

**Institucioni i arsimit të lartë siguron marrëdhënie bashkëpunimi me institucione, kompani, palë të treta, aktorë të biznesit vendas dhe/ose të huaj në funksion të realizimit të programit të studimit, në përputhje me fushën dhe specifikën e këtyre të fundit.**

<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni për hartimin, mbikëqyrjen dhe mbarëvajtjen e programit siguron marrëdhënie bashkëpunimi brenda institucionit nëpërmjet ndarjes së detyrave mes njësive e personelit, marrjes së përgjegjësiwe respektive dhe analizës së vazhdueshme të punës së tyre.</p>	<p>Për përmbushjen e këtij kriteri GVJ konsultoi RVB, si dhe mori informacione plotësuese gjatë vizitës në institucion. GVJ konstaton se në Universitetin Polis ka marrëdhënie bashkëpunimi funksionale midis të gjitha njësive kryesore e ato bazë brenda institucionit. Njësitë bazë të këtij institucioni, ndër to edhe Departamenti Arkitekturë dhe Inxhinieri, organizojnë veprimtari mësimore dhe kërkimore shkencore në koordinim të plotë me njësitë kryesore (fakultetet). Në rastin konkret GVJ u informua për një sërë aktiviteteve me pjesëmarrje të studentëve e pedagogëve. Bashkëpunimi është i njehsueshëm në aktivitetet e promovimit të institucionit, në koordinimin e trajnimeve, objektivat për rritjen e cilësisë së botimeve shkencore si dhe në përdorimin e ambienteve të përbashkëta. GVJ konstaton që ky bashkëpunim është i qëndrueshëm dhe efikas. <i>GVJ nuk konstatoi shkresa zyrtare</i></p>

	<p><i>apo marrëveshje të shkruara që rregullojnë bashkëpunimin e brendshëm midis njësive bazë dhe atyre kryesore në UP.</i></p> <p><i>Referencë: Dokumentet e DVV (RVBP), Protokoli i takimeve gjatë vizitës në Institucion</i></p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Për realizimin e objektivave e procesit mësimor e formues të studentëve, institucioni vendos marrëdhënie bashkëpunimi me institucionet homologe brenda dhe/ ose jashtë vendit, aktorët e biznesit vendës dhe/ ose të huaj.</p>	<p>Përveç gjetjeve në DVV, lidhur me bashkëpunimin e institucionit me institucione homologe, brenda e jashtë vendit, si dhe aktorët e biznesit, vendës e të huaj, në realizimin e objektivave të procesit mësimor e formues të studentëve, GVJ u informua konkretisht edhe gjatë takimit me përfaqësuesit e zyrës së projekteve e marrëdhënieve ndërkombëtare, ku mësoi se kjo zyrë ka funksion koordinues për projektet, duke u fokusuar si në projektet e brendshme ashtu edhe në ato të jashtme.</p> <p>Sipas dokumentacionit të DVV, UP bashkëpunon me 61 institucione apo organizata, kombëtare dhe ndërkombëtare, nga të cilat 11 janë universitete. Me këta partnerë ekzistojnë marrëveshje të nënshkruara, të cilat përfshijnë edhe fushën e inxhinierisë së ndërtimit.</p> <p>Gjithashtu UP ka siguruar marrëveshje bashkëpunimi me institucione të shoqërisë civile kombëtare dhe ndërkombëtare si Kuvendi i Shqipërisë, akademia e shkencave, instituti i monumenteve të kulturës, arkivi qendror teknik i ndërtimit, instituti italian i kulturës, Bashkia Tiranë, Bashkia Durrës, Bashkia Dropull, Bashkia Sarandë, Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, etj.</p> <p>GVJ u informua gjithashtu që studentët e programit të studimit Bachelor në “Inxhinieri Ndërtimi” mund të përfitojnë edhe nga mundësitë e ofruara nga kompani vendase apo të huaja në kuadër të marrëveshjeve të bashkëpunimit, që ato kanë me universitetin. Disa nga kompanitë janë Co-plan, Metropolis, Kastrati Construction, Lindner Group, Alba Engineering, HMK Consulting, Speed Engineering, Kika Construction, Guri shpk, Everest Group, etj.</p> <p><i>Referencë: DVV (dokumenti 34), protokoli i takimeve gjatë vizitës në Institucion</i></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Në mënyrë periodike, njësia përgjegjëse për programin e studimit harton raporte analitike të përfitimeve nga marrëveshjet e bashkëpunimit në funksion të realizimit të programeve të studimeve.</p>	<p>Njësia e sigurimit të cilësisë vlerëson performancën e komponentëve për përmirësimin dhe rritjen profesionale. Të dhënat e procesit të vlerësimit paraqiten në një raport vjetor, i cili i vihet në dispozicion të senatit akademik. Mbi bazën e këtij raporti senati përpilon rekomandime konkrete për përsosjen e mësimdhënies.</p> <p><i>(Ref: Aneks 8)</i></p>




<p><b>Kriteri 4.</b> Institucioni vendos marrëdhënie zyrtare e bashkëpunon me punëdhënësit për kryerjen dhe mbikëqyrjen e praktikës, në varësi të natyrës specifike të programeve të studimeve që ofrojnë.</p>	<p>Praktikat e studentëve zhvillohen kryesisht pranë kompanive me të cilat institucioni ka marrëveshje bashkëpunimi. Nëse studentët zgjedhin kompani apo institucione të tjera, atëherë paraprakisht kryhet vlerësimi i tyre, me qëllim që të realizohet një praktikë sa më efektive.</p>			
<p><b>Kriteri 5.</b> Institucioni ofron trajnime profesionale të mëtijshme për studentët e diplomuar në bashkërendim me punëdhënësit.</p>	<p>Studentët që kanë përfunduar ciklin e parë të studimeve kanë mundësi të zhvillojnë trainime të mëtijshme profesionale, në kuadrin e studimeve master, të ofruar në bashkëpunim me institucione ndërkombëtare, në fushat e arkitekturës, inxhinierisë dhe planifikimit urban.</p> <p>Natyra e programeve në këto nivele studimi është praktike, me fokus kryesor zotërimin e programeve kompjuterike të nevojshme për zhvillimin e mëtijshëm profesional sipas interesit. Programet lidhen me ceshtje thelbësore të projektimit parametrik në arkitekturë dhe inxhinieri si dhe aplikimet GIS në shkallë më të madhe. Krahas programeve master profesional, U_POLIS gjithashtu ofron kurse pasuniversitare me fokus vlerësimin e pasurive të paluajtshme dhe auditit energjistik të banesave.</p>			
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<p><b>Nuk përmbushet</b></p>	<p><b>Përmbushet pjesërisht</b></p>	<p><b>Përmbushet kryesisht</b></p>	<p><b>Përmbushet plotësisht</b></p>
				<p><b>X</b></p>

<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës I</b></p>	<p><b>Nuk përmbushet</b></p>	<p><b>Përmbushet pjesërisht</b></p>	<p><b>Përmbushet kryesisht</b></p>	<p><b>Përmbushet plotësisht</b></p>
				<p><b>X</b></p>

## II. ORGANIZIMI, DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I PROGRAMEVE TË STUDIMIT TË CIKLIT TË PARË BACHELOR

<p><b>Standardi II.1</b>  <b>Programet e studimeve organizohen në përputhje me parashikimet ligjore e përcaktimet nënligjore kombëtare në fuqi për këto programe studimi.</b></p>	
<p><b>Kriteret</b></p>	<p><b>Vlerësimi i ekspertëve</b></p>
<p><b>Kriteri 1.</b> Programet e studimit janë të organizuara në lëndë e module dhe të vlerësuara në kredite, në përputhje me legjislacionin vendës në fuqi dhe sipas Sistemit Evropian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS).</p>	<p>Programi i studimit Bachelor në “Inxhinieri Ndërtimi” është i strukturuar në 3 vite akademike dhe 6 semestra të rregullt. Zhvillohen gjithsej 35 lëndë të ndara sipas 3 viteve akademike (10 lëndë në vitin e parë; 12 lëndë në vitin e dytë; 13 lëndë në vitin e tretë). Në 35 lëndët që parashikohen në planin mësimor përfshihen edhe punimi i diplomës ose provimi final, si edhe praktika profesionale. Lëndë të detyrueshme janë 35. Lëndë</p>




	<p>me zgjedhje janë 0. Bazuar në legjislacionin kombëtar në fuqi (VKM 879, datë 18.12.2019) lëndët janë ndarë në pesë kategori (A, B, C, D, E).</p> <p>Duke iu referuar kurrikulës programit të studimit dhe rregullores vërehet që programi i studimit Bachelor në Inxhinieri Ndërtimi është organizuar në lëndë e module dhe të vlerësuara në kredite, në përputhje me legjislacionin vendës në fuqi dhe sipas Sistemit Evropian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS). Një semestër i rregullt përmban 30 ECTS. Bazuar në Rregulloren e organizimi të programit të studimit, kreditet ECTS të çdo disipline mësimore dhe veprimtarie formuese përlllogariten duke mbajtur parasysh ngarkesën në orë mësimore në auditor, si dhe punën individuale që duhet kryer nga studenti për përmbushjen e të gjitha detyrimeve të parashikuara në programin e lëndës. Një kredit është 25 orë mësimore punë e studentit, ku futen orë mësimore në auditor (leksione, seminare, ushtrime, projekt/detyra, veprimtari të tjera formuese brenda disiplinës), si dhe orë pune individuale të studentit. Sasia totale e krediteve (ECTS), për të tre vitet akademike është 180.</p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Programet e studimeve të ciklit të parë synojnë formimin e shprehive të veçanta në një llojshmëri të gjerë profesionesh e specialitetesh.</p>	<p>Bazuar në planin mësimor, si edhe në programet e lëndëve mund të arrihet në përfundimin se programi i studimit Bachelor në Inxhinieri Ndërtimi siguron formimin e shprehive të veçanta në një gamë të gjerë specialitetesh të përshtatshme për ambiente të ndryshme pune në analizë, dizajn dhe menaxhim ndërtimi. Punëdhënësit e ardhshëm përfshijnë, por nuk kufizohen vetëm në kontraktorët e ndërtimeve, firmat këshilluese, firmat industriale, agjensitë e ndryshme qeveritare, etj. Të diplomuarit gjithashtu fitojnë kompetencat e nevojshme për të vazhduar karrierën e tyre akademike.</p> <p><i>Referencë: Dosja e plotë e programit të studimit me elementët përbërës të tij</i></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Programet e studimit të ciklit të parë japin njohuri të përparuar në fushë studimi ose punësimi, ku përfshihet të kuptuarit kritik të teorive dhe parimeve akademike të fushës.</p>	<p>Lëndët e parashikuara të zhvillohen në programin e studimit Bachelor në Inxhinieri Ndërtimi janë të larmishme. Fillohet me shkrim akademik, gjeometri deskriptive, vazhdohet me matematikë, fizikë, kimi, e deri te mekanika, statika e strukturave, hidraulika, gjeodezia, konstruksionet betonarme, konstruksionet e çelikut, etj. Programet lëndore (syllabuset) të hartuara synojnë të rrisin aftësinë e studentëve të kuptojnë parimet e inxhinierisë gjeoteknike (sjellja e dherave, projektimi i themeleve), inxhinierisë së strukturave (analiza</p>

	<p>dhe projektimi i strukturave prej betoni të armuar dhe strukturat e çelikut), inxhinierisë hidraulike (funizim me ujë dhe kanalizime, burimet ujore), etj.</p> <p>Si pasojë programi ofron njohuri të përparuara, ku përfshihet të kuptuarit kritik të teorive dhe parimeve akademike të fushës.</p> <p><i>Referencë: Kurrikula e PS</i></p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Programet e studimit të ciklit të parë zhvillojnë njohuri, aftësi dhe kompetenca të avancuara në fusha akademike ose profesionale, të nevojshme për zgjidhjen e problemeve komplekse dhe të paparashikueshme në një fushë të specializuar studimi ose profesionale.</p>	<p>Duke iu referuar kurrikulës së PS Bachelor në “Inxhinieri Ndërtimi”, vërehet që krahas lëndëve të përgjithshme dhe atyre praktike në planin mësimor janë parashikuar të zhvillohen edhe lëndë që ofrojnë njohuri të thelluara dhe të përparuara në fusha akademike apo profesionale. Përfshihen këtu lëndë të zhvilluara kryesisht në vitin e tretë dhe që lidhen me analizën e strukturave, strukturat b.a., strukturat e çelikut, themelet, etj.</p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Programet e studimit të ciklit të parë përmbajnë të gjitha elementet që përbëjnë strukturën e programit të studimit të përcaktuara në akte ligjore e nënligjore.</p>	<p>Sipas gjykimit të GVJ elementet e programit të studimit Bachelor në Inxhinieri Ndërtimi janë në përputhje me Vendimin e Këshillit të Ministrave (VKM) Nr. 41, datë 24.01.2018, "<i>Për elementet e programeve të studimit të ofruara nga Institucionet e Arsimit të Lartë</i>", si edhe VKM Nr. 879, datë 18.12.2019.</p> <p>Kurrikula dhe programet e lëndëve (syllabuset), të programit të studimit Bachelor në Inxhinieri Ndërtimi, janë në përputhje të plotë me VKM-të e mësipërme.</p> <p>Programi i studimit Bachelor në “Inxhinieri Ndërtimi” është një program studimi i ciklit të parë. Ka një kohëzgjatje normale prej tre vitesh akademike dhe plotësohet me 180 ECTS. Forma e studimeve të programit të ciklit të parë të studimit Bachelor në “Inxhinieri Ndërtimi” është me kohë të plotë dhe gjuha e mësimdhënies është gjuha shqipe.</p> <p>Pas përfundimit të kërkesave për diplomim nga programi i studimit në fjalë, studentit i lëshohet diploma “Bachelor” në Inxhinieri Ndërtimi.</p>
<p><b>Kriteri 6.</b> Programet e studimit kanë të përcaktuar qartë veprimtaritë formuese duke grupuar lëndët/ modulet sipas kategoritë të përcaktuara dhe me ngarkesën përkatëse në kredite.</p>	<p>Bazuar në legjislacionin kombëtar në fuqi (VKM 879, datë 18.12.2019) lëndët janë ndarë në pesë kategori (A, B, C, D, E). Në kategorinë A bëjnë pjesë 5 lëndë, në kategorinë B bëjnë pjesë 17 lëndë, në kategorinë C bëjnë pjesë 5 lëndë, në kategorinë D bëjnë pjesë 7 lëndë, në kategorinë E bëjnë pjesë 1 lëndë. Bazuar në kreditet përkatëse lëndët e kategorive të ndryshme kanë këtë shpërndarje:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• kategoria A – 33 ECTS (18.33%)</li> <li>• kategoria B – 93 ECTS (51.66%)</li> </ul>



	<ul style="list-style-type: none"> <li>• kategoria C – 21 ECTS (11.66%)</li> <li>• kategoria D – 27 ECTS (15.00%)</li> <li>• kategoria E – 6 ECTS (3.33%)</li> </ul> <p>Bazuar në (VKM 879, datë 18.12.2019) shpërndarja e lëndëve është e rregullt dhe në përputhje me legjislacionin kombëtar në fuqi.</p> <p><i>Referencë: Kurrikula e PS</i></p>						
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<table border="1"> <thead> <tr> <th>Përmbushet pjesërisht</th> <th>Përmbushet kryesisht</th> <th>Përmbushet plotësisht</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td></td> <td></td> <td>X</td> </tr> </tbody> </table>	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht			X
Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht					
		X					


<b>Standardi II.2</b>	
<b>Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush kërkesat ligjore për këto njësi.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<p><b>Kriteri 1.</b> Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit, përmbush detyrimet ligjore për vlerësimin dhe akreditimin.</p>	<p>Departamenti Arkitekturë dhe Inxhinieri (DAI) është pjesë përbërëse e Fakultetit Arkitekturë dhe Dizajn.</p> <p>Personeli Akademik Efektiv i DAI, përgjegjës për programin e studimit, përbëhet nga 18 pedagogë:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- 1 Profesor Dr.</li> <li>- 0 Profesor i Asoc. Dr.</li> <li>- 8 Doktorë</li> <li>- 5 Doktorë në proces</li> <li>- 4 MSc</li> </ul> <p>Personeli Akademik me Kontratë i DAI, përgjegjës për programin e studimit, përbëhet nga 4 pedagogë:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- 0 Profesor Dr.</li> <li>- 0 Profesor i Asoc. Dr.</li> <li>- 0 Doktor</li> <li>- 0 Doktor në proces</li> <li>- 4 MSc</li> </ul> <p>Universiteti Polis ka përmbushur standardet dhe ka marrë akreditimin përkatës të programit të studimit Bachelor në Inxhinieri Ndërtimi, Urdhër nr. 270, datë 20.05.2016.</p> <p>Nga sa më sipër rezulton se njësia kryesore dhe ajo bazë, përgjegjëse për programin e studimit, përmbushin detyrimet ligjore për vlerësimin dhe akreditimin.</p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin për çdo program studimi cakton një person në rolin e koordinitorit të programit</p>	<p>Me vendimin e datës 01.10.2021, rektori i UP cakton si koordinitor të programit të studimit Bachelor në "Inxhinieri Ndërtimi", Doc. Dr. M. Guri. Në vendim shpjegohen detyrat kryesore të koordinitorit të programit, si mëposht:</p> <p>1. Monitoron dhe</p>




<p>të studimit i cili është përgjegjës për ecurinë dhe zhvillimin e programit dhe praktikave profesionale në përputhje me objektivat e tij. Koordinator i programit informon vazhdimisht titullarin e njësisë përkatëse.</p>	<p>koordinon procesin mësimor, në bashkëpunim me Sekretarinë Mësimore dhe fakultetin përgjegjës;</p> <p>2. Koordinon dhe bashkëpunon me studentët duke i mbështetur, dhe ndihmuar për proceset akademike, i orienton ata drejt njësive me të cilat duhet komunikojnë për tematika të ndryshme;</p> <p>3. Monitoron dhe koordinon me dekanatin, zbatimin e kurrikulës, hedhjen e saj në sistemin elektronik në kohë nga përgjegjësit e kurrikulës;</p> <p>4. Bashkëpunon me NJBSC, dhe sigurohet që procesi i vlerësimit është kryer nga studentët dhe stafi i programit në fjalë;</p> <p>5. Identifikon rezultatet dhe pritshmëritë e programit, krahasuar me zhvillimet e tregut si dhe ofertat e aktorëve të tjerë në treg për këtë program ose programe të ngjashme me të.</p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush, detyrimet ligjore dhe nënligjore për organizimin dhe strukturën akademike.</p>	<p>Fakulteti është njësia kryesore akademike e Universitetit Polis, që koordinon mësimdhënien, kërkimin shkencor dhe zhvillimin kulturor në fushat mësimore-kërkimore. UP është i përbërë nga 3 (tre) fakultete. Autoritetet udhëheqëse akademike janë dekani dhe përgjegjësit e departamenteve. Organi kryesor akademik i fakultetit është dekanati. Autoriteti kryesor administrativ është administratori i fakultetit.</p> <p>Fakulteti Arkitekturë dhe Dizajn përbëhet nga 2 (dy) departamente që funksionojnë si njësi bazë me objektiva dhe mision të qartë, të përcaktuara në rregulloret përkatëse:</p> <ol style="list-style-type: none"> <li>1. Departamenti Arkitekturë dhe Inxhinieri</li> <li>2. Departamenti Art dhe Dizajn.</li> </ol> <p>Qendra studimore ndërdisiplinore kërkimore dhe e inovacionit funksionon si njësi kërkimore shkencore, në përmbushje të ligjit të arsimit të lartë.</p> <p>Nga sa më sipër njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush, detyrimet ligjore dhe nënligjore për organizimin dhe strukturën akademike.</p> <p><i>Referencë: Statuti i UP, Rregullorja e njësive bazë/njësive kryesore, Rregullorja e programit të studimit</i></p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit, përmbush detyrimet për numrin dhe shkallën e kualifikimit të personelit</p>	<p>Fakulteti Arkitekturë dhe Dizajn, si njësia kryesore përgjegjëse për programin e studimit Bachelor në Inxhinieri Ndërtimi, ka në përbërje të tij 46 pedagogë, nga të cilët 35 janë PAE dhe 11 PAK. 15 pedagogë PAE janë me grada e tituj shkencorë. 3 pedagogë PAK kanë gradën shkencore Doktor.</p>

akademik.	<p>Departamenti Arkitekturë dhe Inxhinieri, si njësi bazë përgjegjëse për programin e studimit Bachelor në Inxhinieri Ndërtimi, ka në përbërje të tij 22 pedagogë, nga të cilët 18 janë PAE dhe 4 PAK. 9 pedagogë PAE janë me grada e tituj shkencorë, specifikisht:</p> <p>1 Prof.Dr. 8 Dr.</p> <p>Nga sa më sipër rezulton se njësi kryesore dhe ajo bazë, përgjegjëse për programin e studimit, përmbush detyrimet ligjore për numrin dhe shkallën e kualifikimit të personelit akademik.</p>			
<p><b>Kriteri 5.</b> Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit, përmbush detyrimet ligjore dhe nënligjore për organizimin dhe strukturën akademike.</p>	<p>Fakulteti është njësi kryesore akademike e Universitetit Polis, që koordinon mësimdhënien, kërkimin shkencor dhe zhvillimin kulturor në fushat mësimore-kërkimore. UP është i përbërë nga 3 (tre) fakultete. Autoritetet udhëheqëse akademike janë Dekani dhe Përgjegjësit e Departamenteve. Organi kryesor akademik i fakultetit është Dekanati. Autoriteti kryesor administrativ është Administratori i Fakultetit.</p> <p>Fakulteti Arkitekturë dhe Dizajn përbëhet nga 2 (dy) departamente dhe 1 (një) njësi kërkimore shkencore, të cilët funksionojnë si njësi bazë me objektiva dhe mision të qartë, të përcaktuara në rregulloret përkatëse:</p> <ol style="list-style-type: none"> <li>1. Departamenti Arkitekturë dhe Inxhinieri;</li> <li>2. Departamenti Art dhe Dizajn;</li> <li>3. Qendra Kërkimore në Arkitekturë, Inxhinieri dhe Dizajn.</li> </ol> <p>Nga sa më sipër njësi kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush, detyrimet ligjore dhe nënligjore për organizimin dhe strukturën akademike.</p> <p><i>Referencë: Statuti i UP, Rregullorja e njësisë bazë/njësisë kryesore, Rregullorja e programit të studimit</i></p>			
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p> <p style="text-align: center;"><b>X</b></p>

<p><b>Standardi II.3</b>  <b>Programet e studimeve të ciklit të parë janë të detajuara, informuese, të strukturuar dhe organizuara në përputhje me parashikimet dhe objektivat formuese të programeve të ciklit të parë.</b></p>	
<p><b>Kriteret</b></p> <p><b>Kriteri 1.</b> Njësia kryesore/bazë, përgjegjëse për programet e studimit të ciklit të parë, disponojnë informacionet e nevojshme për organizimin, strukturën dhe përmbajtjen e programeve të</p>	<p><b>Vlerësimi i ekspertëve</b></p> <p>Departamenti Arkitekturë dhe Inxhinierisë zotëron informacionet e nevojshme për organizimin dhe përmbajtjen e programit të studimit Bachelor në Inxhinieri Ndërtimi. Si pjesë të këtij informacioni mund të përmendim që nga plani strategjik i programit të</p>



studimeve.	studimit, plani strategjik i universitetit, statuti i universitetit, plani i financimit, rregullorja e universitetit, rregullorja e fakultetit, rregullorja didaktike, rregullorja e NJSBC, rregullorja e diplomimit e deri tek rregulloret e sekretarisë dhe zyrës së burimeve njerëzore. Të gjitha informacionet janë të publikuara në faqen e internetit të universitetit dhe të aksesueshme nga të gjithë. (Ref: Aneks 2,3, 4, 5, 6, 7, 8, 9, 10 dhe 11)
<p><b>Kriteri 2.</b> Programet e studimit organizohen në lëndë, module, praktikë e aktivitete formuese, në përputhje me përcaktimet ligjore në fuqi.</p>	<p>Programi i studimit Bachelor në Inxhinieri Ndërtimi është i strukturuar në 3 vite akademike dhe 6 semestra. Zhvillohen gjithsej 35 lëndë (180 ECTS), të ndara sipas 3 viteve akademike (10 lëndë në vitin e parë; 12 lëndë në vitin e dytë; 13 lëndë në vitin e tretë). Në 35 lëndët që parashikohen në planin mësimor përfshihen edhe punimi i diplomës ose provimi final, si edhe praktika. Lëndë të detyrueshme janë 35. Lëndë me zgjedhje nuk janë parashikuar. Bazuar në legjislacionin kombëtar në fuqi (VKM 879, datë 18.12.2019) lëndët janë ndarë në pesë kategori (A, B, C, D, E).</p> <p>Në kategorinë A bëjnë pjesë 5 lëndë, në kategorinë B bëjnë pjesë 17 lëndë, në kategorinë C bëjnë pjesë 5 lëndë, në kategorinë D bëjnë pjesë 7 lëndë, në kategorinë E bëjnë pjesë 1 lëndë. Bazuar në kreditet përkatëse lëndët e kategorive të ndryshme kanë këtë shpërndarje:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• kategoria A – 18.33%</li> <li>• kategoria B – 51.66%</li> <li>• kategoria C – 11.66%</li> <li>• kategoria D – 15.00%</li> <li>• kategoria E – 3.33%</li> </ul> <p>Bazuar në (VKM 879, datë 18.12.2019) shpërndarja e lëndëve është përgjithësisht e rregullt dhe në përputhje me legjislacionin kombëtar në fuqi.</p> <p>Programi i studimit Bachelor në Inxhinieri Ndërtimi është organizuar në lëndë e module dhe të vlerësuara në kredite, në përputhje me legjislacionin vendës në fuqi dhe sipas Sistemit Evropian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS).</p> <p>(Ref: Aneks 52, Tabela 11)</p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Programet e studimit organizohen në lëndë e module, të vlerësuara me kredite sipas sistemit vendës e evropian, të ndara në vite e semestra.</p>	<p>Programi i studimit Bachelor në Inxhinieri Ndërtimi është organizuar në lëndë e module dhe të vlerësuara në kredite, në përputhje me legjislacionin vendës në fuqi dhe sipas Sistemit Evropian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS).</p>



	<p>të Krediteve (ECTS). (Ref: Aneks 14)</p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Programet e studimit përmbajnë planin mësimor, ku përfshihen informacionet e nevojshme për ngarkesën mësimore, orët në auditor/jashtë auditorit, frekuentimin/ndjekjen e programit dhe mënyrën e vlerësimit të dijeve etj.</p>	<p>Plani mësimor i programit të studimit Bachelor në “Inxhinieri Ndërtimi” përmban të gjithë informacionet e nevojshme për ngarkesën mësimore, orët në auditor/jashtë auditorit, frekuentimin/ndjekjen e programit. Mënyra e vlerësimit të dijeve tregohet në rregulloren e PS. Mbështetet në parimin e kontrollit të vazhduar. Mënyra e vlerësimit varet nga tipologjia e lëndës. <i>Referencë: Rregullorja e programit të studimit, programet e lëndëve</i></p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Programet e studimit përmbajnë të gjitha informacionet e nevojshme për studentët që lidhen me kriteret e përgjithshme dhe specifike të pranimit, transferimit dhe ekuivalentimit të studimeve.</p>	<p>Të gjithë kandidatët që dëshirojnë të regjistrohen në programin e studimit Bachelor në Inxhinieri Ndërtimi duhet të plotësojnë përkatësisht kriteret e pranimit, të ndjekin procedurat e regjistrimit dhe plotësojnë dokumentacionin. Institucioni, nëpërmjet zyrës së pranimeve, pajis studentët me të gjithë informacionin e nevojshëm lidhur me kriteret e përgjithshme dhe të veçanta për pranim, transfertë dhe njehsim studimesh. Të gjitha informacionet janë bërë publike dhe vënë në dispozicion të publikut në faqen e internetit të universitetit, si dhe janë të detajuara në rregulloren e programit të studimit. Bazuar në rregulloren e PS, për t’u pranuar në këtë program studimi kandidati/student duhet të ketë përfunduar me sukses shkollën e mesme, të plotësojë kriterin e notës mesatare të përcaktuar sipas legjislacionit në fuqi, të zotërojë një diplomë të shkollës së mesme të përgjithshme me kohëzgjatje tre vjet, ose sipas sistemit të vjetër me kohëzgjatje katër vjet, ose edhe shkollë të mesme profesionale.</p>
<p><b>Kriteri 6.</b> Programet e studimit përmbajnë informacionet e nevojshme për programet lëndore (silabuset e detajuara) për secilën lëndë, për praktikat, seminarat apo orët e laboratorit, si dhe të gjithë komponentët formues të programit brenda dhe jashtë auditorit në përputhje me formatet e miratuara.</p>	<p>Programet e lëndëve përmbajnë informacionet e nevojshme për praktikat, seminarat apo orët e laboratorit, si dhe të gjithë komponentët formues të programit brenda dhe jashtë auditorit në përputhje me formatet e miratuara dhe me një cilësi të mirë. Syllabuset, për secilën lëndë, ofrojnë të gjitha informacionet e nevojshme lidhur me ngarkesën brenda dhe jashtë auditorit, kreditet, përshkrimin e lëndës, objektivat e lëndës, temat për secilën javë, literaturë kryesore dhe mbështetëse, rezultatet e të nxëniet të lëndës, kontributi i lëndës në kompetencat e programit të studimit, metodat e vlerësimit të njohurive dhe llogaritjen e ECTS.</p>


	<i>Referencë: Programet e lëndëve të ofruara ndër vite</i>		
<b>Kriteri 7.</b> Përmbajtja e programeve të studimit është në përmirësim dhe përditësim të vazhdueshëm dhe në fillim të çdo viti akademik miratohen ndryshimet eventuale dhe arkivohet dosja e plotë.	Universiteti përdor të dhëna cilësore dhe sasiore në vlerësimin e lëndëve, programeve të lëndëve dhe mësimdhënies, duke përfshirë studentët dhe palët e interesuara, për të identifikuar pikat e forta dhe të dobëta të programeve të studimit. Kjo politikë vlen për të gjitha programet e studimit të ofruara nga universiteti. Para fillimit të çdo viti akademik zhvillohen takime pune për të parë nevojën e përmirësimit të përmbajtjes së programit të studimit. Shqyrtimi i secilit program studimi administrohet nga departamenti përkatës. Vendimet për rishikimin e kurrikulave merren mbi bazën e propozimeve të njësive bazë. Pas kësaj vendimet e njësive bazë kalojnë për miratim në këshillin e fakultetit dhe në senat.		
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
			<b>X</b>

#### Standardi II.4

**Struktura, organizimi dhe përmbajtja e programeve të studimit është në përputhje me objektivat formuese, nivelin e kualifikimit sipas Kuadrit Kombëtar dhe Evropian të Kualifikimeve, rezultateve të të nxënit dhe vazhdimin të studimeve, kompetencave në përputhje me kërkesat e tregut të punës.**

<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Ngarkesa e programit të studimit është strukturuar në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore në fuqi.	Ngarkesa e programit të studimit është treguar në mënyrë të detajuar në programet e lëndëve. Shpërndarja e ngarkesës së punës është bërë në përputhje me ECTS përkatëse dhe respekton parashikimet ligjore dhe nënligjore në fuqi. <i>(Ref: Aneks 25, Tabela 4)</i>
<b>Kriteri 2.</b> Emërtimi, përmbajtja e veprimtarive, shpërndarja e lëndëve dhe praktikave mundësojnë, njohuri, aftësi dhe/ose punësim të studentëve.	Emërtimi, përmbajtja e veprimtarive, shpërndarja e lëndëve dhe praktikave mundësojnë njohuri, aftësi dhe/ose punësim të studentëve. Në vitin e parë zhvillohen lëndë bazë si matematikë, fizikë, kimi, etj. Më tej kalohet gradualisht në lëndë më profesionale. Në vitin e dytë dhe të tretë zhvillohen lëndë të mirëfillta inxhinierike, që përfshijnë studimin dhe zbatimin e parimeve të inxhinierisë gjeoteknike, inxhinierisë së strukturave betonarme dhe çeliku, inxhinierisë hidraulike dhe qasjes së sistemeve të përgjithshme për problemet e inxhinierisë. Studentët zhvillojnë laboratore në lëndë të ndryshme, praktikë profesionale, si edhe njihen me përdorimin e

	<p>programeve kompiuterike inxhinierike. (Ref: Aneks 14)</p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Lëndët/modulet, shpërndarja në vite e semestra, vlerësimi në kredite e orë mësimore mundëson arritjen e objektivave formuese të programit të studimit dhe rezultateve të pritshme të të nxënit dhe aftësisimit profesional.</p>	<p>Në vitin e parë zhvillohen lëndë bazë si matematikë, fizikë, kimi, etj. Më tej kalohet gradualisht në lëndë më profesionale. Një perceptim i fortë i parimeve praktike dhe fizike nxitet dhe promovohet, duke ofruar një bollëk mundësish mësimnxënieje.</p> <p>Përgjatë programit, studentëve u ofrohen mundësi që të përforcojnë aftësitë e tyre grafike dhe të komunikimit me gojë. Viti i dytë dhe i tretë përbëhen kryesisht nga lëndë themelore të inxhinierisë që përfshijnë studimin dhe zbatimin e parimeve të inxhinierisë gjeoteknike (sjellja e dherave, projektimi i themeleve), inxhinieria strukturore (analiza dhe projektimi i strukturave të betonit të armuar dhe çelikut), inxhinieria hidraulike (ligjet themelore të statikës dhe dinamikës së lëngjeve e në vecanti të ujit nën veprimin e forcave në mjedise të kufizuara dhe jo të kufizuara, kriteret e lëvizjes laminare e turbulente për studimin e lëngjeve reale). Dy vitet e fundit të programit të studimit i dedikohen studimit të plotë të bazave teorike të shkencës së inxhinierisë të ndërtimit. Në të njëjtën kohë, zbatimi praktik i njohurive të inxhinierisë të ndërtimit paraqitet dhe zbatohet përmes detyrave të kursit dhe projekteve. Studentëve iu ofrohen njohuri menaxheriale, si edhe kryerja e një praktike verore në kantier.</p> <p>Për më tepër, studenti sfidohet duke parë rolin e inxhinierit nga një këndvështrim ndërdisiplinor dhe multidisiplinor. Zhvillohet gjithashtu roli i inxhinierit si menaxher. Për të zhvilluar më tej aftësi inxhinierike për praktikën profesionale, programi i studimit përfundon me plotësimin e një praktike profesionale.</p> <p>Nga sa më sipër rezulton se lëndët/modulet, shpërndarja në vite e semestra, vlerësimi në kredite e orë mësimore mundëson arritjen e objektivave formuese të programit të studimit dhe rezultateve të pritshme të të nxënit dhe aftësisimit profesional.</p> <p>(Ref: Aneks 14)</p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Struktura e programit, lëndët dhe emërtimi i tyre, ngarkesa në kredite, raporti teori praktikë është në përputhje me profilin e programit bachelor dhe e përafërt me programe të ngjashme ndërkombëtare.</p>	<p>Struktura e programit, lëndët dhe emërtimi i tyre, ngarkesa në kredite, raporti teori – praktikë është në përputhje me profilin e programit të studimit.</p> <p>Struktura e programit është krijuar duke u bazuar në përvojën e stafit, brenda dhe jashtë vendit dhe është e përafërt me programe të ngjashme ndërkombëtare.</p>



	(Ref: Aneks 14, 20 dhe 22)
<b>Kriteri 5.</b> Ndarja sipas veprimtarive formuese dhe raportet midis formimit teorik dhe praktik mundësojnë arritjen e objektivave formues, transferim të studimeve, mobilitet dhe punësim në përfundim të studimeve.	<p>Plani mësimor i programit të studimit Bachelor në Inxhinieri Ndërtimi parashikon lëndë themelore, karakterizuese, ndërdisiplinore, plotësuese dhe përmbyllëse, në përputhje të plotë me kërkesat ligjore, duke lehtësuar transferimin dhe lëvizshmërinë e studentëve. Bazuar në lëndën specifike, programi i saj paraqet një shpërndarje të qartë të ngarkesës teorike dhe praktike për t'i mundësuar studentit procesin e mësimnxënies praktike. Për më tepër, programi i studimit ka përfshirë në kurrikulën e tij mundësi praktike në terren. Studentët duhet të fitojnë dhe përmirësojnë njohuri praktike në tema të ndryshme inxhinierike që mund të hasin gjatë periudhës së praktikës në një kompani ndërtimi.</p> <p>(Ref: Aneks 14, 32 dhe 34)</p>
<b>Kriteri 6.</b> Programet e lëndëve/moduleve përditësohen në mënyrë të vazhdueshme duke u bazuar në literaturë të detyruar dhe ndihmëse të 5 viteve të fundit.	<p>Programet e lëndëve rishikohen çdo fillim semestri nga titullari i lëndës dhe miratohen nga drejtuesi i departamentit. Si rregull programet e lëndëve/moduleve bazohen në literaturë të detyruar dhe ndihmëse të 5 viteve të fundit. Programi i studimit hartohet dhe rishikohet duke marrë parasysh zhvillimet bashkëkohore në fushën e inxhinierisë, bazuar edhe në kërkesat e tregut të punës.</p>
<b>Kriteri 7.</b> Përmbajtja e programeve të studimit garanton përfitim të dijeve, aftësive dhe kompetencave të synuara për programet e studimit të ciklit të parë.	<p>Përmbajtja e programit të studimit Bachelor në Inxhinieri Ndërtimi i ofron studentëve njohuri dhe dije bazë dhe specifike në këtë fushë. Niveli i njohurive është në përputhje edhe me nivelin e ciklit të parë të studimeve, duke krijuar bazat e duhura për një studim me të thelluar dhe të përparuar në ciklin e dytë, master. Krahas njohurive shkencore teorike synohet aftësimi praktik i studentëve nëpërmjet laboratorëve dhe praktikave.</p> <p>Si përfundim synohet që studenti të përvetësojë njohuri shkencore, aftësi praktike dhe menaxheriale.</p> <p>(Ref: Aneks 14)</p>
<b>Kriteri 8.</b> Përmbajtja e programeve të studimit mundëson vijimin e mëtejshëm të studimeve dhe/ose punësimin e studentëve në përshtatje me pritshmëritë e kërkesat e tregut e punës.	<p>Përmbajtja e programit të studimit Bachelor në Inxhinieri Ndërtimi i ofron studentëve njohuri dhe dije bazë dhe specifike në këtë fushë. Niveli i njohurive është në përputhje edhe me nivelin e ciklit të parë të studimeve, duke krijuar bazat e duhura për një studim me të thelluar dhe të përparuar në ciklin e dytë, master.</p> <p>Lëndët që zhvillohen dhe sidomos programet e tyre janë të tilla, që krijojnë te studentët një bazë shumë të mirë shkencore për vijimin e mëtejshëm të studimeve dhe/ose</p>



	punësimin e tyre në përshtatje me pritshmëritë e kërkesat e tregut e punës. (Ref: Aneks 14)			
<b>Kriteri 9.</b> Për përmirësimin e përbajtjes së programeve të studimit dhe për përshtatjen sa më mirë me kërkesat e tregut e punës, strukturat përgjegjëse konsultohen dhe marrin parasysh propozimet e bashkëpunëtorëve dhe partnerëve nga tregu i punës.	Institucioni, Fakulteti Arkitekturë dhe Dizajn, si edhe Departamenti Arkitekturë dhe Inxhinieri, si njësi përgjegjëse për programin e studimit, është vazhdimisht në marrëdhënie me partnerët industrialë dhe tregun në përgjithësi, me qëllim evidentimin dhe inserimin në programet e lëndëve të nevojave dhe kërkesave të tregut. (Ref: Aneks 32)			
<b>Shkalla e përbushjes së standardit</b>	<b>Përbushet plotësisht</b>	<b>Përbushet pjesërisht</b>	<b>Përbushet kryesisht</b>	<b>Përbushet plotësisht</b>
				<b>X</b>

### Standardi II.5

**Personeli akademik dhe ndihmës-akademik përgjegjës për realizimin e programit të studimit përbush kërkesat ligjore dhe ka kualifikimin e duhur e të posaçëm akademik për garantimin e standardeve të mësimdhënies.**

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve																																																																												
<b>Kriteri 1.</b> Personeli akademik me kohë të plotë dhe kohë të pjesshme, që angazhohen në realizimin e programit të studimit, përbushin kërkesat ligjore në fuqi.	<p>Personeli akademik i angazhuar në zhvillimin e programit të studimit Bachelor në Inxhinieri Ndërtimi në tre vitet e fundit, është me grada shkencore dhe tituj akademikë, si edhe kualifikim Msc, konform kërkesave të legjisllacionit në fuqi. Personeli akademik ka ekspertizën e nevojshme për zhvillimin e lëndëve ku është angazhuar.</p> <p>Personeli akademik i brendshëm (PAE) sipas viteve rezultojnë se është me këtë kualifikim (Tabela 6):</p> <table border="1"> <thead> <tr> <th></th> <th>2016-2017</th> <th>2017-2018</th> <th>2018-2019</th> <th>2019-2020</th> <th>2020-2021</th> <th>2021-2022</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td>Prof. Dr</td> <td>3</td> <td>2</td> <td>1</td> <td>1</td> <td>1</td> <td>1</td> </tr> <tr> <td>Prof. Asoc</td> <td>1</td> <td>0</td> <td>0</td> <td>1</td> <td>1</td> <td>1</td> </tr> <tr> <td>Dr/PhD</td> <td>4</td> <td>6</td> <td>5</td> <td>5</td> <td>4</td> <td>11</td> </tr> <tr> <td>Msc (Dr ne process)</td> <td>5</td> <td>3</td> <td>7</td> <td>8</td> <td>7</td> <td>8</td> </tr> <tr> <td>Msc</td> <td>3</td> <td>2</td> <td>3</td> <td>3</td> <td>3</td> <td>6</td> </tr> <tr> <td><b>Totali</b></td> <td><b>16</b></td> <td><b>13</b></td> <td><b>16</b></td> <td><b>18</b></td> <td><b>16</b></td> <td><b>27</b></td> </tr> </tbody> </table> <p>Personeli akademik i jashtëm (PAK) sipas viteve rezultojnë se është me këtë kualifikim (Tabela 6):</p> <table border="1"> <thead> <tr> <th></th> <th>2016-2017</th> <th>2017-2018</th> <th>2018-2019</th> <th>2019-2020</th> <th>2020-2021</th> <th>2021-2022</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td>Prof. Dr</td> <td>0</td> <td>0</td> <td>1</td> <td>0</td> <td>0</td> <td>0</td> </tr> <tr> <td>Prof. Asoc</td> <td>1</td> <td>1</td> <td>1</td> <td>0</td> <td>0</td> <td>0</td> </tr> </tbody> </table>								2016-2017	2017-2018	2018-2019	2019-2020	2020-2021	2021-2022	Prof. Dr	3	2	1	1	1	1	Prof. Asoc	1	0	0	1	1	1	Dr/PhD	4	6	5	5	4	11	Msc (Dr ne process)	5	3	7	8	7	8	Msc	3	2	3	3	3	6	<b>Totali</b>	<b>16</b>	<b>13</b>	<b>16</b>	<b>18</b>	<b>16</b>	<b>27</b>		2016-2017	2017-2018	2018-2019	2019-2020	2020-2021	2021-2022	Prof. Dr	0	0	1	0	0	0	Prof. Asoc	1	1	1	0	0	0
	2016-2017	2017-2018	2018-2019	2019-2020	2020-2021	2021-2022																																																																							
Prof. Dr	3	2	1	1	1	1																																																																							
Prof. Asoc	1	0	0	1	1	1																																																																							
Dr/PhD	4	6	5	5	4	11																																																																							
Msc (Dr ne process)	5	3	7	8	7	8																																																																							
Msc	3	2	3	3	3	6																																																																							
<b>Totali</b>	<b>16</b>	<b>13</b>	<b>16</b>	<b>18</b>	<b>16</b>	<b>27</b>																																																																							
	2016-2017	2017-2018	2018-2019	2019-2020	2020-2021	2021-2022																																																																							
Prof. Dr	0	0	1	0	0	0																																																																							
Prof. Asoc	1	1	1	0	0	0																																																																							

Dr/PhD	1	0	0	1	0	3
Msc (Dr ne process)	0	1	0	0	1	0
Msc	0	2	2	1	3	5
<b>Totali</b>	<b>2</b>	<b>4</b>	<b>4</b>	<b>2</b>	<b>4</b>	<b>8</b>

Raporti i tyre i llogaritur me ngarkesën në orë mësimore (Tabela 12) rezulton:

**Për 2016-2017**

PAE 165 ECTS (93.9%) dhe PAK 15 ECTS (6.1%)

**Për 2017-2018**

PAE 136 ECTS (75.6%) dhe PAK 44 ECTS (24.4%)

**Për 2018-2019**

PAE 151.5 ECTS (84.2%) dhe PAK 28.5 ECTS (15.8%)

**Për 2019-2020**

PAE 171 ECTS (95%) dhe PAK 9 ECTS (5%)

**Për 2020-2021**

PAE 171.5 ECTS (95.3%) dhe PAK 8.5 ECTS (4.7%)

**Për 2021-2022**

PAE – 155.5 ECTS (86.4%) dhe PAK – 24.5 ECTS (13.6%)

Pra në të 6 vitet plotësohet kriteri ligjor për PAE që ka mbështetur me mbi 70% ngarkesën mësimore.

**Kriteri 2.** Personeli akademik me kohë të plotë dhe kohë të pjesshme që angazhohen në realizimin e programit të studimit kanë nivelin e duhur të kualifikimit akademik për drejtimin e programit, drejtimin dhe angazhimin në mbulimin e moduleve mësimore të programit të studimit.

Pas shqyrtimit të dokumentacionit përkatës (CV-të e stafit akademik të angazhuar në programin e studimit), si dhe takimit me stafin akademik, u konstatua se personeli akademik me kohë të plotë dhe me kohë të pjesshme i angazhuar në programin e studimit Bachelor në “Inxhinieri Ndërtimi” zotëron kualifikimin e duhur akademik, në nivelin e kërkuar për mësimdhënie dhe kryerje të veprimtarive të tjera mësimore në lëndët e programit në fjalë.

**Kriteri 3.** Niveli i kualifikimit dhe fusha akademike-kërkimore e përgjithshme dhe specifike e anëtarëve të personelit akademik që mbulon programin e studimit, janë në përputhje me programin e studimit, natyrën dhe specifikën e moduleve të tij.

Pas shqyrtimit të dokumentacionit përkatës (CV-të e stafit akademik të angazhuar në programin e studimit), si dhe takimit të zhvilluar me stafin akademik, u konstatua se niveli i kualifikimit dhe fusha akademike-kërkimore e anëtarëve të personelit akademik që mbulojnë programin e studimit Bachelor në “Inxhinieri Ndërtimi” është në përputhje me natyrën dhe specifikën e programit dhe moduleve të tij. Specifikisht, stafi akademik është i specializuar në disiplina të ndryshme të Inxhinirisë së Ndërtimit si: inxhinieri stukturash, materiale, menaxhim, gjeoteknike, hidroteknike, etj. Lëndët ofrohen nga

	pedagogë me tituj akademikë dhe disa lëndë kryhen nga disa pedagogë.			
<b>Kriteri 4.</b> Institucioni, në marrëveshje dhe në bashkëpunim me institucione të tjera të arsimit të lartë, përfaqësues biznesi e kompani, vë në dispozicion personelin e mjaftueshëm, të duhur e të kualifikuar për instruktimin, udhëheqjen dhe mbikëqyrjen e studentëve në praktikën profesionale, punimin e diplomës dhe veprimtari të tjera specifike sipas natyrës së programit të studimit.	Institucioni ka lidhur marrëveshje bashkëpunimi me institucionet homologe brenda dhe jashtë vendit ose kompani të ndryshme, si: ALUFLOR, LINDNER GROUP, KASTRATI SHPK, etj. Marrëveshjet realizohen nëpërmjet Zyrës së Karrierës, me qëllim kryerjen dhe mbështetjen e praktikës profesionale të studentëve të ciklit të parë të studimeve në Inxhinieri Ndërtimi. Departamenti gjithashtu mbështet marrëdhëniet me ndërmarrjet / punëdhënësit. (Ref: Aneks 34)			
<b>Kriteri 5.</b> Institucioni siguron dhe garanton angazhimin e personelit ndihmës mësimor shkencor të përshtatshëm për realizimin e orëve laboratorike dhe për mirëmbajtjen e laboratorëve e mjediseve të tjera mësimore, sipas natyrës specifike të programit të studimit.	Në UP funksionojnë këta laboratorë: <ul style="list-style-type: none"> <li>• Innovation factory</li> <li>• Laboratori i eficiencës së energjisë</li> <li>• Laboratori 3D LAB</li> <li>• Laboratori CAD LAB</li> </ul> Gjatë vizitës në UP, GVJ konstatoi se personeli i angazhuar në laboratorë zotëronte aftësitë e duhura teknike dhe didaktike, në funksion të realizimit cilësor të orëve laboratorike, sipas veçorive të programit të studimit.			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Në përmbushje</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				<b>X</b>

<b>Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës II</b>	<b>Në përmbushje</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				<b>X</b>

### III. MËSIMDHËNIA, MËSIMNXËNIA, VLERËSIMI DHE KOMPETENCAT

<b>Standardi III.1</b>	
<b>Institucionin ndjek një politikë të qartë për garantimin dhe promovimin e cilësisë së mësimdhënies dhe harton udhëzues të posaçëm të zhvillimit të metodave dhe monitorimit.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni harton udhëzues në nivel institucional për zhvillimin dhe përdorimin e metodave të ndryshme dhe inovative të mësimdhënies në bazë	UP udhëzon pedagogët për mënyrën e hartimit të syllabuseve, për metodat e mësimdhënies, përzgjedhjen e literaturës, etj., nëpërmjet shfrytëzimit të përvojës kombëtare dhe ndërkombëtare, duke përqëndruar

Adresa: "Rruga e Durrësit", Nr. 219 Tiranë

E-mail: info@ascal.al

Tel: +355 (04) 22-43423

Web site: [www.ascal.al](http://www.ascal.al)

Faqe 27

të fushës së studimeve, lëndëve/ moduleve.	vëmendjen veçanërisht të asistent lektorët. (Ref: Aneks 39 dhe 46)
<b>Kriteri 2.</b> Strukturat përgjegjëse zhvillojnë mekanizma të monitorimit dhe vlerësojnë në mënyrë periodike aftësitë mësimdhënëse dhe inovative të personelit akademik dhe ndihmës akademik.	Drejtuasi i departamentit është direkt personi përgjegjës për monitorimin e cilësisë së mësimdhënies. Institucioni kryen monitorimin sistematik të stafit nëpërmjet disa mekanizmave që u evidentuan edhe gjatë vizitë në IAL. Vlerësimi synon përmirësimin dhe rritjen e cilësisë së mësimdhënies dhe mësimnxënies. Vlerësimi kryhet me metoda të drejtpërdrejta dhe të tërthorta, të fshehta, duke përfshirë edhe studentët. Aplikohet edhe kontrolli i drejtpërdrejtë në mësim nga ana e drejtuesit të departamentit. Janë përgatitur formularët e vetëvlerësimit, si edhe formularët e vlerësimit të studentëve. (Ref: Aneks 41)
<b>Kriteri 3.</b> Institucioni garanton përfshirjen e studentëve në vlerësimin periodik të formave e metodave të mësimdhënies, të vlerësimit të dijeve, përfshirë mundësinë e trajtimit të ankimeve.	Bazuar ne RVB dhe gjate vizites ne IAL, ky i fundit siguron përfshirjen e studentëve në vlerësimin periodik të formave dhe metodave të mësimdhënies, të vlerësimit të dijeve, duke përfshirë edhe mundësinë e trajtimit të ankesave. Janë të drejtpërdrejta dhe të tërthorta, të fshehta (ku ruhet anonimat) dhe të hapura. Për sa i takon ankesave, studenti i drejtohet direkt drejtuesit të departamentit, bazuar edhe në rregulloren e institucionit.
<b>Kriteri 4.</b> Strukturat përgjegjëse për monitorimin dhe sigurimin e cilësisë në mësimdhënie bëjnë publike rezultatet e vlerësimit.	Rezultatet e vlerësimit bëhen publike në mënyrë shumë të kujdesshme, për të mos cënuar në objektivitetin e kryerjes së detyrës nga pedagogu. Gjithsesi drejtuesi i departamentit ia bën të ditur rezultatet e vlerësimit personelit akademik. Më tej departamentit analizon rezultatet, verifikon besueshmërinë e tyre, si edhe nxjerr përfundimet përkatëse.
<b>Kriteri 5.</b> Institucioni, nëpërmjet mekanizmave të vlerësimit dhe rezultateve të marra, promovon shembuj të praktikave të mira, nxit dhe inkurajon personelin akademik për përmirësimin e mëtejshëm të cilësisë së mësimdhënies.	Institucioni promovon shembuj të praktikave më të mira, si dhe inkurajon dhe motivon stafin akademik për të përmirësuar më tej mësimdhënien, duke organizuar aktivitete të ndryshme trajnimit, leksione të hapura dhe seminare me profesorë të ftuar nga universitete të shquara. Nga ana tjetër, institucioni është i përfshirë në projekte të ndryshme ndërkombëtare, si dhe ka nënshkruar memorandum mirëkuptimi me universitete ndërkombëtare, përmes të cilave motivon stafin të marrë pjesë në programet e mobilitetit të stafit si Erasmus + KA1 ose KA2, për të përmirësuar aftësitë e tyre mësimdhënëse. Gjithashtu, institucioni promovon shembujt e praktikave më të mira përmes mjeteve të tij të komunikimit siç janë emaili ose faqja e internetit e universitetit.




Shkalla e përmbushjes së standardit	Përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

### Standardi III.2

**Institucioni garanton zhvillimin e mësimdhënies, mësimnxënies dhe aftësimin profesional e shkencor me metodat dhe praktikat më të mira.**

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p><b>Kriteri 1.</b> Format e mësimdhënies, mësimnxënies dhe transmetimit të dijeve e njohurive janë leksionet, seminarët, laboratorët, detyra kursit/ esetë, praktikat profesionale e klinike, orët e hapura dhe çdo formë tjetër e miratuar nga institucioni.</p>	<p>Elementet e studimeve të parashikuara në rregulloren e institucionit në përputhje me specifikën e programit të studimit përfshijnë leksionet, seminarët, ushtrimet, laboratorët, praktikat mësimore e profesionale, provimet e ndërmjetme dhe përfundimtare, detyrat e kursit, projekte, etj. Ndarja e tyre në program është si më poshtë:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Leksione <b>1080</b> orë mësimore</li> <li>- Seminare <b>597</b> orë mësimore</li> <li>- Ushtrime / Laboratorë <b>344</b> orë mësimore</li> <li>- Praktika/Detyra <b>0</b> orë mësimore</li> <li>- Praktikë profesionale <b>120</b> orë mësimore</li> <li>- Diploma/Provim formimi <b>62</b> orë mësimore</li> <li>- Punë individuale e st. <b>2297</b> orë mësimore</li> <li>- Gjithsej <b>4500</b> orë mësimore</li> </ul> <p>Përveç kësaj DIA organizon edhe leksione të hapur me ekspertë të fushës së ndërtimit.</p> <p><i>Referencë: Programi i lëndëve, anekse, tabela përmbledhëse të PS</i></p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Personeli akademik pranon, duhet të respektojë dhe t'u përgjigjet diversitetit dhe nevojave të studentëve, duke ofruar forma, mënyra, metoda e mundësi alternative të mësimdhënies e mësimnxënies, në përputhje me fushën dhe natyrën e programit të studimit në përgjithësi dhe moduleve e aktiviteteve formuese në veçanti.</p>	<p>Mësimdhënia në UP rezulton e larmishme, në varësi të specifikave të lëndëve dhe nevojave të studentëve. Ofrohen mundësi të barabarta për të gjithë studentët, pavarësisht nivelit të përgatitjes së tyre. Format e mësimdhënies mbajnë parasysh rezultatet e vlerësimeve të ndryshme, të kryera herë pas here.</p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Institucioni mbështet personelin e tij akademik në përmirësimin e kompetencave didaktike. Institucioni mundëson përdorimin e metodave të shumëllojshme dhe fleksible pedagogjike, të përshtatshme e në</p>	<p>Institucioni mbështet stafin e tij akademik për të përmirësuar kompetencat didaktike, si dhe inkurajon dhe motivon stafin akademik për të përmirësuar më tej mësimdhënien duke organizuar aktivitete të ndryshme trajnimi, leksione të hapura dhe ëorkshope me profesorë të ftuar nga universitete të ndryshme. Nga ana tjetër, DAI</p>

<p>përputhje me rezultatet e pritshme të të nxënit, objektivat formues dhe kërkesat e punëdhënësve.</p>	<p>ofron metoda pedagogjike shumë të larmishme dhe fleksibile përveç metodave të zakonshme të mësimdhënies siç janë leksionet dhe seminarët, studentët marrin pjesë në punën laboratorike, japin detyra kursi dhe projekte, zhvillojnë prezantime etj. Departamenti ka organizuar disa aktivitete me përfaqësuesit e industrisë së ndërtimit për të kuptuar më mirë pritshmëritë e tregut. <i>Referencë: Plani strategjik i UP, plani strategjik i DAI 2021-2026</i></p>			
<p><b>Kriteri 4.</b> Personeli akademik i angazhuar në mësimdhënie është kompetent në shpjegimin e njohurive e koncepteve dhe përdor metoda të ndryshme të mësimdhënies sipas tematikave dhe profilit.</p>	<p>Personeli akademik angazhohet në mësimdhënie përmes një procesi dinamik të vlerësimit të njohurive, kompetencave dhe metodologjisë në mësimdhënie. Ky vlerësim fillon që në fazën e rekrutimit. Gjithashtu, gjatë vizitës në universitet, u diskutua mbi shpërndarjen e lëndëve të programit tek stafi akademik, e cila realizohej duke u bazuar në fushat e ekspertizës. Nga ana tjetër, personeli akademik i DAI përmirësohet vazhdimisht duke marrë pjesë në projekte të ndryshme ndërkombëtare dhe aktivitete trajnimi, si dhe organizon aktivitete trajnimi brenda departamentit.</p>			
<p><b>Kriteri 5.</b> Personeli akademik vlerëson dhe përmirëson format e metodat e mësimdhënies në mënyrë periodike, duke përfshirë studentët në këtë proces dhe duke reflektuar mendimet e sugjerimet e tyre.</p>	<p>Bazuar ne RVB dhe gjatë vizitës në IAL (të shpjeguara në RVB) institucioni thith mendimet dhe sugjerimet e studentëve në lidhje me problematikat e procesit mësimor. Pas kësaj drejtuesi i departamentit kryen verifikimet përkatëse dhe propozon masat përkatëse, të cilat konsistojnë në ndryshimin e rregulloreve apo të zëvendësimit të pedagogut, i cili nuk e ka kompetencën e duhur profesionale dhe didaktike.</p>			
<p><b>Kriteri 6.</b> Personeli akademik përdor metoda interaktive dhe diskutimi, duke i bërë tërheqëse orët e mësimit.</p>	<p>GVJ gjatë vizitës në institucion dhe nga bisedat me studentët konstatoi se metodat e mësimdhënies janë ato klasike, duke u përpjekur të përfshijnë studentët sa më shumë në diskutime dhe zgjidhje të situatave konkrete, shoqëruar me kalkulimet përkatëse dhe vizatimet grafike.</p>			
<p><b>Kriteri 7.</b> Format dhe metodat e mësimdhënies inkurajojnë sensin e autonomisë të studentit, duke siguruar në të njëjtën kohë udhëzimin dhe mbështetjen nga mësimdhënësi dhe ndërtimin e marrëdhënieve të respektit të ndërsjellë mes tyre.</p>	<p>Prezantimet e punimeve nga ana e studentëve, projektet, detyrat dhe punimet laboratorike, inkurajojnë ndjenjën e pavarësisë së studentit, punën në grup dhe të menduarit kritik. Në të njëjtën kohë ofrohet mbikqyrje dhe mbështetje nga ana e pedagogëve, duke ndërtuar kështu një mjedis bashkëpunues, në të cilin studentët mund të zhvillojnë vetëbesimin e tyre. <i>Referencë: Programet e lëndëve</i></p>			
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<p><b>Nuk përmbushet</b></p>	<p><b>Përmbushet pjesërisht</b></p>	<p><b>Përmbushet kryesisht</b></p>	<p><b>Përmbushet plotësisht</b></p>
				<b>X</b>



**Standardi III.3**

Njësitë përgjegjëse garantojnë zhvillimin e mësimdhënies, mësimnxënies dhe aftësimin profesional duke vënë në dispozicion të gjithë infrastrukturën fizike, didaktike e logjistike e nevojshme për realizimin me sukses të aktivitetit mësimor e shkencor.

<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Procesi mësimor e shkencor realizohet në hapësira të mjaftueshme dhe cilësore, të cilat janë të pastra dhe mirëmbahen rregullisht.	Procesi i mësimdhënies dhe ai shkencor kryhen në ambiente të përshtatshme dhe cilësore, të cilat mirëmbahen dhe ruhen si duhet. Institucioni ka pasur ambiente cilësore që nga fillimi i tij. Një ekip me teknikë është i punësuar, që të përkujdeset për të gjitha objektet, përfshirë materialet, sistemin elektrik, ngrohjen e të gjitha ambjenteve të brendshme në dimër, ajrin e kondicionuar gjatë verës, etj. <i>Referencë: Infrastruktura në funksion të programit të studimit</i>
<b>Kriteri 2.</b> Ambientet e dedikuara për procesin mësimor janë funksionale dhe të pajisura me logjistikën e nevojshme për realizimin me cilësi të procesit mësimor.	Ambientet e dedikuara për procesin e mësimdhënies janë të kompletuara mirë me pajisjet e nevojshme, duke përfshirë projektorë, tabela smart, kompjuter në laboratorë dhe instrumente eksperimentale, internet, etj. Gjithashtu, studentët e inxhinierisë së ndërtimit kanë mundësinë që të zhvillojnë seancat e tyre laboratorike në laboratorët përkatës, të cilët ofrojnë mundësinë për të kryer prova dhe studime shkencore në të gjitha nëndisiplinat e inxhinierisë së ndërtimit. Programi i Studimit Bachelor në Inxhinieri Ndërtimi ka asistencën e një sërë laboratorësh si “TF Innovation factory” me 3Dprinting Lab/ FabLab, Laboratorin e Energjisë, dhe 4 laboratorë të specializuar kompjuterike (CAD, Sap, Etabs, Tekla, BIM, Mac, GIS, etj). <i>Referencë: Infrastruktura në funksion të programit të studimit</i>
<b>Kriteri 3.</b> Personeli akademik dhe studentët shfrytëzojnë sisteme të ndryshme informatike, infrastrukturë të konsoliduar IT të nevojshme për realizimin e procesit mësimor.	Stafi akademik dhe studentët përdorin sisteme të ndryshme informatike dhe infrastrukturë të konsoliduar të IT-së të nevojshme për procesin e mësimdhënies. Sistemi RASH bën të mundur që studenti në kohë reale të njihet me materialet e depozituara nga pedagogët.
<b>Kriteri 4.</b> Literatura bazë dhe ndihmëse e vënë në dispozicion të studentëve në gjuhën e programit të studimit (fizike dhe elektronike), garanton marrjen e dijeve dhe njohurive të nevojshme të parashikuara në programin e studimit.	Institucioni vë në dispozicion një numër të përshtatshëm të teksteve bazë dhe literaturë ndihmëse në ambientet e bibliotekës. Literatura është bashkëkohore dhe pasqyrohet në programet e lëndëve. Bazuar në kërkesat e stafit akademik, kjo literaturë zgjerohet dhe vihet në shërbim të studentëve. Universiteti gjithashtu ka arritshmëri në një numër bibliotekash online.



	<i>Referencë: Infrastruktura në funksion të programit të studimit</i>
<b>Kriteri 5.</b> Biblioteka e institucionit garanton numër të mjaftueshëm botimesh të viteve të fundit, në drejtimet kryesore të programit të studimit dhe hapësira të mjaftueshme dhe komode për përdorim nga studentët gjatë procesit mësimor.	Biblioteka ka një fond shumë të pasur librash për secilin nga programet e studimit të ofruar nga Universiteti. Universiteti ofron ambiente komode për lexim dhe sallë studimi. Titujt e librave vlerësohen si të bollshëm e mëse të mjaftueshëm për përfundimin e suksesshëm të programit të studimit Bachelor në “Inxhinieri Ndërtimi”. Biblioteka pasurohet çdo vit. Librat e bibliotekës janë inventarizuar dhe ndarë sipas fushave dhe temave. Literatura e bibliotekës mund të gjendet në gjuhë të ndryshme si: anglisht, shqip, italisht, frëngjisht etj. Librat e blerë janë zgjedhur sipas nevojave dhe kërkesave të studentëve dhe stafit akademik.
<b>Kriteri 6.</b> Në funksion të mësimdhënies dhe mësimnxënies, personeli akademik dhe studentët aksesojnë libraritë on-line të fushave të ngjashme ose të përafërta me programin e studimit.	GVJ konstatoi se personeli akademik dhe studentët shfrytëzojnë bibliotekat online të fushave të përafërta me programin e studimit.
<b>Kriteri 7.</b> Infrastruktura laboratorike e nevojshme për realizimin e laboratorëve, detyrave të kursit, diplomave dhe studimeve specifike shfrytëzohet në mënyrë të vazhdueshme nga studentët.	Gjatë vizitës në UP, në bashkëbisedimet me studentët dhe stafin akademik, GVJ konstatoi se infrastruktura laboratorike shfrytëzohet në mënyrë konkrete dhe të dobishme.
<b>Kriteri 8.</b> Në funksion të mësimdhënies, personeli akademik përdor platforma on-line (e-learning) dhe mbështet dhe nxit personelin akademik e studentët për përdorimin e tyre.	Institucioni ka vënë në dispozicion të personelit akademik dhe të studentëve paketën e plotë G Suit të Google, e cila mundëson një seri shërbimesh. Gjatë periudhës së pandemisë kjo paketë tregoi efektivitetin e saj për organizimin e mësimin online. Platforma Google Drive përdoret edhe në ditët e sotme një strukturë paralele komunikimi për studentët dhe pedagogët. Nëpërmjet platformës Turnitin përmirësohet integriteti akademik, ndihmohet procesi i vlerësimit, pengohet plagjiatura, etj.
<b>Kriteri 9.</b> Personeli akademik dhe studentët shfrytëzojnë sistemet e komunikimit të brendshëm për akses në dokumentacionin elektronik dhe hapësirën vetjake të dedikuar.	Personeli akademik dhe studentët shfrytëzojnë arkivën digjitale të institucionit, si edhe platformën google drive për të shkëmbyer material.
<b>Kriteri 10.</b> Personeli akademik orienton studentët në përzgjedhjen e temave të diplomave (në rastet kur ato zhvillohen), asiston dhe mbështet në zhvillimin e tyre.	Posaçërisht për temën e diplomës është krijuar lënda “Teza dhe projekt diploma”, gjatë të cilës studentët do të përgatiten për provimin e formimit. Gjithashtu do të përgatitin edhe projektin e një vile banimi me dy kate. Studentët gjatë gjithë kohës do të kenë mundësi të punojnë të mbështetur nga pedagogët përkatës.



Shkalla e përmbushjes së standardit	Përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X
<b>Standardi III.4</b>				
<b>Institucioni ngre struktura të posaçme në nivel institucional, të cilat promovojnë rritjen e vetëdijes për përmirësimin e cilësisë së mësimdhënies dhe mësimnxënies në programet e studimit.</b>				
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>			
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni organizon struktura/njësi në nivel institucional që promovojnë përmirësimin e vazhdueshëm të mësimdhënies, koordinojnë dhe bashkërendojnë me njësitë kryesore/bazë aktivitetet në kuadër të përmirësimit të cilësisë së mësimdhënies.	Në përputhje me legjislacionin e arsimit të lartë është krijuar njësi e brendshme e sigurimit të cilësisë si një strukturë e pavarur dhe përhershme. Kjo njësi vlerëson periodikisht rezultatet e veprimtarive mësimore dhe kërkimore shkencore, duke propozuar ndryshime dhe përmirësime, të cilat i gjykon të arsyeshme. Njësi e brendshme e sigurimit të cilësisë bashkëpunon dhe bashkëvepron me njësitë kryesore dhe bazë për rritjen e cilësisë së mësimdhënies, duke synuar konsolidimin e kulturës së cilësisë në UP. NjsBC përbëhet nga 9 anëtarë, një ndër të cilët është përfaqësues i studentëve dhe një ekspert i jashtëm. Është hartuar edhe një rregullore për funksionimin e NjsBC.			
<b>Kriteri 2.</b> Njësi kryesore/bazë është përgjegjës për cilësinë e mësimdhënies dhe rritjes së vetëdijes te personeli akademik dhe studentët për cilësinë në programet e studimit që ofron.	DAI është përgjegjës për cilësinë e mësimdhënies në programin studimor Bachelor në Inxhinieri Ndertimi. Departamenti, me anë të një programi vjetor aktivitetesh, workshop-esh dhe takimesh, synon rritjen e vetëdijes së stafit akademik dhe studentëve për cilësinë e programit të studimit. Specifikisht për studentët e rinj, departamenti organizon javën e orientimit në fillim të çdo viti akademik. Departamenti përzgjedh personelin akademik, që angazhohet në mësimdhënie, shpërndan ngarkesën mësimore, miraton silabuset, vlerëson ecurinë e mësimdhënies me mënyra direkte dhe indirekte. <i>Referencë: DVV, RVB</i>			
<b>Kriteri 3.</b> Strukturat dhe njësitë përgjegjëse mbështesin eksperimentimin dhe zhvillimin e metodave të reja inovative të mësimdhënies.	DAI, si njësi bazë për cilësinë e mësimdhënies, si dhe komisioni i përhershëm për sigurimin e cilësisë, struktura kryesore në nivel institucional për përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë, mbështesin eksperimentimin dhe zhvillimin e metodave të reja inovative të mësimdhënies. Metodat kryesore përfshijnë përfitimin e njohurive përmes teksteve të lëndës, leksioneve, prezantimeve individuale dhe në grup, projekteve kërkimore, leksioneve të hapura, praktika laboratorike, aplikime studimore, ndërveprimet me të ftuar nga fusha e ndërtimit, praktika profesionale, vizita			

	në terren, aktivitete vullnetare, projekte dhe anëtarësime në klubet studentore dhe aktivitete të tjera jashtë shkollore.						
<b>Kriteri 4.</b> Personeli akademik dhe ai mbështetës kualifikohen në mënyrë të vazhdueshme në fushën e kërkimit shkencor për të ndihmuar përmirësimin e mëtejshëm të mësimdhënies.	Nga takimi me stafin akademik të angazhuar në programin studimor, si dhe pas shqyrtimit të CV, konstatohet që personeli akademik dhe ndihmës përfshihen në projekte shkencore rajonale/ndërkombëtare, projekte profesionale vullnetare në ndihmë të komunitetit, seminare, workshop-e, konferenca në fushat përkatëse të kërkimit shkencor. <i>Referencë: DVV, Të dhëna mbi kërkimin shkencor të stafit të DIA</i>						
<b>Kriteri 5.</b> Strukturat dhe njësitë përgjegjëse trajnojnë vazhdimisht personelin akademik për përmirësimin e aftësive të mësimdhënies dhe implementimit të metodave të reja.	Institucioni organizon në mënyrë periodike workshope dhe aktivitete të ndryshme trajnimi, në kuadër të përmirësimit të veprimtarive të mësimdhënies, mësimnxënies dhe kërkimore-shkencore. Këto aktivitete janë të afishuara në faqen e internetit të universitetit.						
<b>Kriteri 6.</b> Personeli akademik dhe personeli ndihmës akademik janë përgjegjës për zbatimin e programeve të studimeve dhe angazhohen për përmirësimin e mësimdhënies dhe implementimin e metodave të reja.	Bazuar në statutin e UP, si dhe në planin strategjik të programit të studimit, personeli akademik i programit të studimit Bachelor në Inxhinieri Ndërtimi është përgjegjës për zbatimin e duhur të programit të studimit dhe është i angazhuar për të përmirësuar mësimdhënien dhe zbatimin e metodave të reja përmes ndjekjes së vazhdueshme të planeve dhe strategjive të hartuara për këtë qëllim. <i>Referencë: Statuti, plani strategjik i programit të studimit</i>						
<b>Kriteri 7.</b> Personeli akademik dhe personeli ndihmës akademik testojnë metoda të reja në mësimdhënie, analizojnë efektet e pritshmëritë dhe raportojnë në mënyrë periodike për rezultatet në strukturat dhe njësitë përgjegjëse.	GVJ u prezantua me aktivitete të ndryshme të zhvilluara, në të cilat personeli akademik teston metoda të reja mësimore. Personeli akademik është i lirë të implementojë metoda e forma inovative të mësimdhënies, t'i analizojë ato, të reflektojë anët pozitive dhe negative, duke kryer edhe ndryshimet përkatëse në silabuset e lëndëve dhe metodat e mësimdhënies e nxënies.						
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<table border="1"> <thead> <tr> <th>Përmbushet pjesërisht</th> <th>Përmbushet kryesisht</th> <th>Përmbushet plotësisht</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td></td> <td></td> <td>X</td> </tr> </tbody> </table>	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht			X
Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht					
		X					

<b>Standardi III.5</b>	
<b>Institucioni harton rregullore dhe procedura të posaçme të testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale dhe garanton zbatimin e tyre.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Kriteret dhe mënyra e testimit e vlerësimit të njohurive dijeve dhe aftësive profesionale, përcaktohen në rregullore të posaçme, bëhen publike dhe	Rregullorja e programit të studimit përcakton kriteret dhe mënyrën e testimit të vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale. Gjithçka i bëhet e qartë studentit gjatë javës së orientimit, si edhe nga pedagogët e lëndëve.

Adresa: "Rruga e Durrësit", Nr. 219 Tiranë

E-mail: info@ascal.al

Tel:+355 (04) 22-43423

Web site: [www.ascal.al](http://www.ascal.al)

Faqe 35

njihen nga studentët.	<i>Referencë: DVV, rregullorja e programit të studimit</i>			
<b>Kriteri 2.</b> Në fillim të çdo lëndë/moduli studentët informohen me metodologjinë e testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore të parashikuara në silabuset e lëndëve/moduleve nga titullari i lëndës/modulit.	Në javën e parë të semestrit akademik studentët njihen me programin e lëndës, përmbajtjen e saj, si edhe formën e vlerësimit. Vlerësimi i përgatitjes akademike të studentit mbështetet në parimin e kontrollit të vazhdueshëm. Në çdo silabus, në bazë të tipologjisë së lëndës, përcaktohet edhe vlerësimi i studentëve. Njoftime më të hollësishme depozitohen në platformën Pitagora. <i>Referencë: DVV, rregullorja e programit të studimit</i>			
<b>Kriteri 3.</b> Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore realizohet në forma dhe mënyra të ndryshme, duke i dhënë mundësi studentit të demonstrojë njohuritë dhe kompetencat e fituara.	Bazuar në shqyrtimin e silabuseve të lëndëve në programin studimor, në rregulloren e PS, si edhe në bisedat me studentët, njohuritë dhe aftësitë e studentëve vlerësohen përmes këtyre formave kryesore: 1) detyra praktike, 2) provime periodike 3) detyra kursi, 4) projekti përfundimtar, 5) prezantime, 6) projekte. <i>Referencë: DVV, rregullorja e programit të studimit</i>			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				<b>X</b>

<b>Standardi III.6</b>	
<b>Institucioni garanton vlerësim të drejtë dhe transparent, bazuar në meritën e çdo studenti..</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale realizohet gjatë gjithë vitit akademik.	Nga shqyrtimi i programeve të lëndëve të PS dhe gjatë takimeve dhe bisedave me studentët dhe stafin akademik konstatohet që testimi dhe vlerësimi i dijeve të studentëve të programit realizohet përgjatë gjithë semestrit akademik. Janë përcaktuar periudha kohore të dedikuara për provimet, provimet e ndërmjetëm dhe provimet përfundimtare.
<b>Kriteri 2.</b> Institucioni vë në zbatim sisteme elektronike të testimit dhe vlerësimit të cilat eliminojnë forma të ndryshme abuzimi dhe rrisin transparencën.	Gjatë vizitës në UP, në bashkëbisedimet me studentët dhe stafin akademik, GVJ konstatoi se testimi kryhet me mënyra klasike, të gjetura të përshtatshme për vetë natyrën e programit të studimit. Nga ana tjetër UP merr masa të posaçme për të shmangur abuzimin dhe rritur transparencën, edhe pse në institucion këto dukuri nuk kanë përbërë asnjëherë problem. Provimet e ndërmjetëm dhe ata përfundimtarë dorëzohen fizikisht dhe elektronikisht dhe ruhen në arkivën e UP.
<b>Kriteri 3.</b> Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale realizohet nga	Gjatë takimeve dhe bashkëbisedimeve me stafin akademik GVJ konfirmon që komisionet provimeve përbëhen nga së paku dy anëtarë. Provimet organizohen në auditor dhe online

Adresa: "Rruga e Durrësit", Nr. 219 Tiranë

E-mail: info@ascal.al

Tel:+355 (04) 22-43423

Web site: [www.ascal.al](http://www.ascal.al)

Faqe 36

komisionet e provimeve me së paku 2 anëtarë ku njëri prej tyre është titullari i lëndës/modulit.	janë bërë gjatë pandemisë.
<b>Kriteri 4.</b> Testimi i vlerësimit i njohurive, dijeve me shkrim, zhvillohet në mënyrë anonime me sekretim ose kodifikim dhe institucioni siguron infrastrukturë të posaçme të monitoruar me personel dhe mjete survejimi.	Stafi akademik i UP e gjen të arsyeshme që provimet të mos sekretohen, me qëllim që pedagogu të mbajë parasysh gjatë kontrollit të provimit ecurinë vjetore të studentit. Salla ku zhvillohet provimi mbikqyret nga disa pedagogë.
<b>Kriteri 5.</b> Vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale shoqërohet me komente/feedback, i cili, nëse është i nevojshëm, lidhet dhe me këshilla mbi procesin e të nxënit për të ndihmuar studentin të përmirësohet në të ardhmen.	Vlerësimi i kompetencave dhe aftësive të studentit, përveç vlerësimit me pike/notë, shoqërohet me komente, veçanërisht në projekte, prezantime dhe forma të tjera të ngjashme vlerësimi. Gjatë takimit me studentët e programit u vu re perceptimi pozitiv mbi komentet, keshillat dhe rekomandimet e pedagogeve në mënyrë që të ndihmojnë studentët të përmirësohen në të ardhmen.
<b>Kriteri 6.</b> Njësitë përgjegjëse dhe personeli akademik shmangin plagjiaturën, kopjimi në provime dhe detyra nuk tolerohen nga personeli akademik.	Universiteti, nëpërmjet rregulloreve të tij, dënon kopjen dhe plagjiaturën. Merren të gjitha masat për të shmangur kopjimin në provime. Gjatë zhvillimit të provimeve salla monitorohet nga dy apo më shumë pedagogë të caktuar e të miratuar nga drejtuesi i departamentit. Plagjiatura dhe kopjimi ndëshkohen me notën 4 (katër). Përveç rregullores së shkruar, universiteti përdor programin Turnitin ephorus si një mekanizëm që kontrollon plagjiaturën për punimet e studentëve.
<b>Kriteri 7.</b> Rezultatet e kontrollit të dijeve dhe aftësive profesionale bazohen mbi meritën dhe jepen në kohë sipas përcaktimeve në rregulloret përkatëse.	Afatet e përfundimit të vlerësimit të dijeve dhe aftësive profesionale janë të përcaktuara qartë dhe të shpallura. Rezultatet e kontrollit të dijeve bazohen në meritën e studentëve. (Ref: Aneks 2, 3 dhe 7)
<b>Kriteri 8.</b> Institucioni garanton të drejtat e studentëve për t'u njohur me vlerësimin, kërkesën për rishikim të vlerësimit në përputhje me rregulloret dhe procedurat e vlerësimit.	Nga shqyrtimi i rregulloreve, si dhe nga konstatimet gjatë vizitës në universitet u konstatua se studentët e ushtrojnë të drejtën e tyre për të kundërshtuar rezultatin e një vlerësimi duke paraqitur një ankesë në departament. Ankesa paraqitet në formën e një formulari të veçantë, brenda një jave pas shpalljes së notave përfundimtare.
<b>Kriteri 9.</b> Çdo kërkesë, ankimim, shqyrtohet nga komisioni i vlerësimit dhe më pas nga komisioni i posaçëm. Procedura e ndjekur dokumentohet dhe arkivohet.	Në rast se studenti ka ankesë për pikët që ka marrë në një nga komponentët e vlerësimit (provim i ndërmjetëm, detyrë kursi/detyra praktike, provim përfundimtar), pasi ka konsumuar procedurën e sqarimit me pedagogun e lëndës ai mund t'i drejtojë një formular me shkrim pranë sekretarisë, brenda një afati prej 3 ditë pune nga shpallja e rezultatit. Kjo ankesë shqyrtohet nga dekani, i cili mund të thërrasë për

	<p>sqarime drejtuesin e njësisë bazë përkatëse, komisionin e provimit dhe vetë studentin. Pas gjykimit të çështjes, merr vendimin përkatës të formës së prerë, brenda tri ditëve pune. Kur ankesa është e drejtë, dekani e shpall të pavlefshëm rezultatin e vlerësimit për të cilin studenti është ankuar dhe vendos që studenti të rivlerësohet ose të rijapë provimin, me një komision të ngritur enkas ku procedura e ndjekur për zgjidhjen e ankesës, si dhe vendimi i marrë, dokumentohet. (Ref: Aneks 2, 3 dhe 7)</p>			
Shkalla e përmbushjes së standardit		Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

### Standardi III.7

**Zhvillimi i programit të studimit garanton rritjen e aftësive krijuese e zbatuese te studentët, duke dhënë njëkohësisht njohuritë e nevojshme dhe kompetencat e duhura profesionale e shkencore.**

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p><b>Kriteri 1.</b> Programi i studimit zhvillohet në mënyrë të tillë që të garantojë thellimin e njohurive, zhvillon aftësitë profesionale dhe të veçanta të studentëve.</p>	<p>Përmbajtja e programit të studimit Bachelor në Inxhinieri Ndërtimi i ofron studentëve njohuri dhe dije bazë dhe specifike në këtë fushë. Niveli i njohurive është në përputhje edhe me nivelin e ciklit të parë të studimeve, duke krijuar bazat e duhura për një studim me të thelluar dhe të përparuar në ciklin e dytë, master. Krahas njohurive shkencore teorike, programi synon aftësimin praktik të studentëve nëpërmjet laboratorëve dhe praktikave.</p> <p>Përveç kurrikulës, studentët marrin pjesë rregullisht në aktivitete jashtë-kurrikulare, siç janë forume të hapura, vizita në terren, konferenca studentore, etj.</p> <p>(Ref: Aneks 14 dhe 19)</p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Programi i studimit garanton zhvillimin e aftësive të veçanta në fushën e teknologjisë së informacionit, humane sociale, komunikimit dhe ndërveprimit (përfshirë edhe në gjuhë të huaj).</p>	<p>Për të përmbushur këtë kriter në planin mësimor të PS përfshihen lëndë të tilla si “Shkrim akademik”, etj. Gjithashtu për zhvillimin e aftësive të veçanta në fushën e teknologjisë së informacionit në planin mësimor janë përfshirë lëndë të tilla si “CAD”, “Analizë dhe projektim strukturor kompiuterik”.</p> <p>Pas tërmetit të 26 nëntorit 2019 stafi dhe studentët u vunë në dispozicion të emergjencave civile të Tiranës dhe Durrësit, për të vlerësuar dëmet dhe ndihmuar njerëzit në nevojë.</p> <p>Studentët trajnohen dhe aftësohen në komunikim me autoritetet publike dhe publikun e gjerë.</p>

	<i>(Ref: Aneks 14 dhe 19)</i>
<b>Kriteri 3.</b> Kompetencat dhe aftësitë që fiton studenti, të paraqitura në programin e studimit dhe silabuset e çdo lënde, analizohen e shqyrtohen në përfundim të çdo lënde.	Kompetencat dhe aftësitë që fiton studenti, të paraqitura në programin e studimit dhe silabuset e çdo lënde, analizohen në përfundim të semestrit akademik. Pedagogët tërheqin mendimin e studentëve për përmirësimin e procesit të mësimdhënies dhe të përmbajtjes së lëndëve. Si një test për të kuptuar se sa kanë përfituar studentët shërben edhe detyra e kursit apo detyra praktike, që realizohen gjatë procesit mësimor.
<b>Kriteri 4.</b> Në përfundim të çdo lënde/moduli, personeli akademik vë në pah çështjet më të rëndësishme dhe orienton studentët për implementimin e tyre.	Në përfundim të çdo lënde pedagogu thekson problemet më të rëndësishme, të cilat do t'u nevojiten studentëve, duke i këshilluar ata për mënyrën e implementimit të tyre.
<b>Kriteri 5.</b> Personeli akademik realizon orë të hapura dhe seminare mbi zhvillime të reja të shkencës dhe teknologjisë jashtë strukturës së programit të studimit.	Personeli akademik i departamentit angazhohet në aktivitete shkencore, prezanton punën e tyre në konferenca dhe simpoziume, merr pjesë dhe organizon workshope, si dhe zhvillon aktivitete kombëtare dhe ndërkombëtare.
<b>Kriteri 6.</b> Mësimdhënia realizohet mbi bazë kompetencash që t'u japë studentëve mundësi të zhvillojnë njohuritë e marra në laboratorë dhe praktikatat profesionale.	Mësimdhënia realizohet mbi bazë kompetencash, të cilat janë të mirëpërcaktuara në programet lëndore. Studentët e programit Bachelor në Inxhinieri Ndërtimi kanë në dispozicion infrastrukturën e nevojshme dhe e përdorin atë për të zhvilluar njohuritë e marra në laboratorët kompjuterikë, në laboratorët e inxhinierisë së ndërtimit, si dhe në praktikatat profesionale. <i>(Ref: Aneks 19)</i>
<b>Kriteri 7.</b> Personeli akademik mbështet diskutimet dhe punën në grup në interpretimin dhe zgjidhjen e problematikave/çështjeve të caktuara.	Diskutimet dhe puna në grup mbi interpretimin dhe zgjidhjen e problematikave të ndryshme është listuar si një ndër kompetencat e programit Bachelor në Inxhinieri Ndërtimi. <i>(Ref: Aneks 19)</i>
<b>Kriteri 8.</b> Personeli akademik krijon klimë të përshtatshme për zhvillimin e ideve inovative, studime të avancuara kërkimore e shkencore dhe mbështetje të studentëve.	Nga vizita në universitet konstatohet se studentët inkurajohen të zhvillojnë ide inovative në detyra e projekte, të avancojnë dhe promovojnë punimet e tyre shkencore në seminare dhe aktivitete kombëtare dhe ndërkombëtare.
<b>Kriteri 9.</b> Institucioni mbështet zhvillimin e ideve inovative, studimet e avancuara kërkimore e shkencore dhe i mbështet financiarisht studentët.	Nga vizita në universitet konstatohet se studentët inkurajohen të zhvillojnë ide inovative të natyrës teknike, shkencore, por edhe sociale. Universiteti u ofron studentëve mundësinë për t'u bashkuar me klubet studentore dhe për të zhvilluar dhe promovuar idetë e tyre inovative dhe aftësi të tjera, duke i mbështetur ato edhe financiarisht.

	<i>(Ref: Aneks 12)</i>		
<b>Kriteri 10.</b> Personeli akademik ndërthur format e mësimdhënies me institucionet bashkëpunuese për të mundësuar dhe rritur mobilitetin e studentëve.	Institucioni ka një numër të konsiderueshëm marrëveshjesh bilaterale për shkëmbimin e studentëve, lista e të cilave është vënë në dispozicion të GVJ. POLIS shkëmben përvojën e tij me këta universitete duke mundësuar rritjen e mobiliteteve të studentëve.		
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Përbushet pjesërisht</b>	<b>Përbushet kryesisht</b>	<b>Përbushet plotësisht</b>
			<b>X</b>

<b>Standardi III.8</b>	
<b>Institucioni ndjek një procedurë të qartë të diplomimit të studentit në programin e studimit dhe e përgatit atë me dokumentacionin e nevojshëm.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni harton procedurë të posaçme për provimin final ose mbrojtjen e diplomës para diplomimit të studentëve dhe e bën atë publike.	Procedura për provimin final dhe mbrojtjen e diplomës para diplomimit të studentëve është e hartuar qartë dhe e publikuar online në faqen e institucionit, nga ku studentët mund të informohen. <i>(Ref: Aneks 10)</i>
<b>Kriteri 2.</b> Strukturat përgjegjëse dhe personeli akademik asistojnë studentët, duke vënë në dispozicion informacione, udhëzime dhe materiale të nevojshme në funksion të provimit final dhe mbrojtjes së diplomës.	Informacioni dhe udhëzimet mbi provimin final dhe mbrojtjen e diplomës para diplomimit të studentëve është i publikuar. Pedagogët përgjegjës organizojnë konsulta periodike në grup ose/edhe në mënyrë individuale, sipas nevojës. Bazuar në rregulloren e diplomimit dhe nga komunikimi me stafin përgjegjës, këto konsulta organizohen në 5 faza, që fillojnë me fazën përgatitore dhe përmbyllen me dorëzimin e provimit final dhe projekt diplomës.
<b>Kriteri 3.</b> Komisioni i posaçëm për administrimin e provimit final bazohet në testimin e njohuritë e dhëna gjatë tri viteve akademike, duke përfshirë të gjitha lëndët/modulet në bazë të rëndësisë dhe peshës specifike.	Provimi formulohet nga grupe të ndryshme pyetjesh të përgatitura nga lëndët teknike në menyrë që të mbulojë modulet e lëndëve që studentët kanë ndjekur gjatë tre viteve të studimeve. Komisioni i ngritur nga Departamenti i drejton pyetje studentit përkatës për të matur njohuritë e tij/saj në lidhje me secilin modul. Nëse studenti rezulton kalues, fiton të drejtën e mbrojtjes së Projekt Diplomës. <i>(Ref: Aneks 10)</i>
<b>Kriteri 4.</b> Personeli akademik orienton dhe ndihmon studentët për përgatitjen e provimit final apo për përgatitjen e temave të studimit/ diplomave.	Nga vizita në universitet dhe shqyrtimi rregullores përkatës mësohet që stafi akademik përgjegjës për provimin e përgjithshëm përfundimtar organizon konsultime periodike të cilat organizohen në 5 faza: 1. Faza përgatitore 2. Faza e parë





	<p>3. Faza e dytë</p> <p>4. Faza e tretë</p> <p>5. Faza e katërt (përmbyllëse)</p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Institucioni asiston studentët për kryerjen e matjeve, analizave, testeve në mjediset e institucionit apo jashtë tij në bazë të temave dhe fushës së studimit.</p>	<p>Nga dokumentacioni i dorëzuar dhe vizita në institucion, rezulton që Universiteti ka vënë në dispozicion të studentëve infrastrukturën e nevojshme, si dhe staf ndihmës për të asistuar studentët për kryerjen e matjeve, analizave dhe testeve të ndryshme. Në rast të mosmbulimit të nevojave të studentëve me anë të infrastrukturës së Universitetit, Institucioni ka lldhur marrëveshje me Kompani dhe Laboratorë që operojnë në fushën e ndërtimit.</p> <p><i>(Ref: Aneks 32)</i></p>
<p><b>Kriteri 6.</b> Udhëheqësi i diplomës (kur aplikohet) asiston studentin në nxjerrjen e rezultateve, përpunimin e tyre, si dhe shkrimin e temës sipas udhëzuesve të miratuar. Ai garanton cilësinë e rezultateve dhe miraton ose jo nëse punimi është i plotë për t'u paraqitur para komisionit.</p>	<p>Pedagogët përgjegjës plotësojnë një program lëndor (syllabus-et) për lëndën e projektit të diplomimit dhe e shpërndajnë atë tek studentët në fillim të semestrit. Pedagogët punojnë me studentët e caktuar përkatësisht në mënyrë kolektive dhe të pavarur dhe ndajnë me to të gjitha materialet që mund t'i ndihmojnë ato të kryejnë punën e tyre kërkimore-shkencore. Udhëheqësit, pas kontrollit të cilësisë dhe atij të plagjiaturës me anë të platformës (turnitin) vendosin nëse studenti është gati të paraqesë punën e tij / saj para një komisionit.</p> <p><i>(Ref: Aneks 10)</i></p>
<p><b>Kriteri 7.</b> Në përfundim të provimit ose mbrojtjes së diplomës, studenti vlerësohet me notë.</p>	<p>Mbrojtja e diplomimës vlerësohet me notë. Bazuar në dokumentacionin e dorëzuar dhe komentet gjatë vizitës, vlera e notës është produkt i ecurisë gjatë semestrit 30%, vlerësimi i oponentit 20% dhe nota e vendosur nga komisioni 50%.</p> <p><i>(Ref: Aneks 10)</i></p>
<p><b>Kriteri 8.</b> Në përfundim të studimeve, studenti pajiset me diplomën dhe suplementin e diplomës, të miratuara nga ministria përgjegjëse për arsimin.</p>	<p>Në përfundim të studimeve, pasi studenti plotëson të gjitha detyrimet dhe kërkesat e procedurës së diplomimit, duke përfshirë 180 ECTS, zyrat përkatëse përfundojnë procedurën zyrtare të diplomimit për studentin. Studenti pajiset me diplomën dhe suplementin e diplomës, të miratuara nga ministria përgjegjëse për arsimin.</p> <p><i>(Ref: Aneks 15)</i></p>
<p><b>Kriteri 9.</b> Në përfundim të studimeve, studentit i vihet në dispozicion kopje e plotë zyrtare e programit të studimit të zhvilluar.</p>	<p>Në përfundim të studimeve, studenti pajiset me një kopje zyrtare, të vulosur, të programit të plotë të zhvilluar. Gjithashtu dokumentacioni rezulton i aksesueshëm edhe online.</p> <p><i>(Ref: Aneks 5, 14)</i></p>
<p><b>Kriteri 10.</b> Institucioni ruan për një periudhë të pacaktuar kopje të</p>	<p>Universiteti arkivon dokumentacionin e studentit</p>



dokumentacionit të studentit dhe paraqet/konfirmon, rast pas rasti, informacione për studentin, nëse kërkohen.	elektronikisht dhe fizikisht. Pas diplomimit dokumentacioni Institucioni e arkivon dokumentacionin e studentit në arkivën qendrore të Universitetit për një afat të pacaktuar.		
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
			X

<b>Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës III</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
			X

#### IV. BURIMET NJERËZORE, FINANCIARE, INFRASTRUKTURA, LOGJISTIKA PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT


<b>Standardi IV.1</b>	
<b>Institucioni i arsimit të lartë ndjek procedura ligjore dhe transparente të rekrutimit, vlerësimit dhe përzgjedhjes së personelit përgjegjës për programin e studimit</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni mbledh, ruan dhe përditëson çdo vit akademik, të dhënat e personelit të angazhuar në programin e studimit. Këto të dhëna përfshijnë anëtarët e personelit akademik të përfshirë në program dhe të personit përgjegjës për organizimin e programit të studimit, angazhimin e çdo anëtari në çdo semestër dhe vit akademik, si dhe atë të personelit ndihmësmësimor-shkencor dhe administrativ.	Refruar RVB si dhe informacioneve të marra gjatë vizitës në institucion GVJ konstaton se në Universitetin POLIS mblidhen, ruhen dhe përditësohen çdo vit akademik të dhënat personale të personelit akademik me kohë të plotë dhe të pjesshme si dhe ato të personelit ndihmës. Në lidhje me mbledhjen e këtyre të dhënave Universiteti "POLIS", nëpërmjet Zyrës së Burimeve Njerëzore, shpërndan tek stafi një formular, i cili kompozohet sipas direktivave të Komisionerit Publik "Për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale". Ky formular plotësohet nga çdo anëtar i stafit. GVJ u informua se, në fillim të çdo viti akademik, Zyra e Burimeve Njerezore, bazuar në propozimet e departamenteve dhe fakulteteve organizon ndarjen e stafit akademik, stafit ndihmës dhe atij mësimor. Ruajtja dhe përditësimi i të dhënave bëhet në dosjet e personelit (formati hard copy dhe formati dixhital). Dosjet hard copy u konsultuan nga GVJ gjatë takimit në Zyrën e Burimeve Njerezore. GVJ konstatoi që dosjet përmbajnë të gjitha të dhënat e kërkuara dhe vetë të dhënat janë të përditësuara.
<b>Kriteri 2.</b> Institucioni harton dhe zbaton procedura për rekrutimin e	Sipas RVB procedurat e Rekrutimit te Stafit ne Universitetin "POLIS" bazohen me Rregulloren e

personelit akademik, në përputhje me bazën ligjore në fuqi dhe aktet e brendshme rregullatore të institucionit.	Përgjithshme të Institucionit dhe Strategjinë e Menaxhimit të Burimeve Njerëzore. Këto procedura janë përputhje me bazën ligjore në fuqi. Gjatë takimit në Zyrën e Burimeve Njerëzore GVJ u interesua të njihet konkretisht me zbatimin e procedurave të rekrutimit të personelit dhe gjeti që ato ishin kryer konform akteve ligjore e nënligjore. <i>(Ref: Aneks 5 dhe 11)</i>			
<b>Kriteri 3.</b> Institucioni harton procedura e kritere të posaçme e specifike për rekrutimin e personelit, të cilat janë pjesë e akteve rregullatore dhe i bën ato publike.	GVJ i konsultoi kriteret dhe procedurat e posaçme e specifike për rekrutimin e personelit të shenjura në dokumentat bazë si: Rregulloren e Përgjithshme, Statutin e Universitetit POLIS dhe Strategjinë e Menaxhimit të Burimeve Njerëzore dhe i gjeti ato të hartuara në përputhje të plotë me bazën ligjore dhe të zbatuara gjatë gjithë aktivitetit për rekrutimin e personelit. Këto akte ishin bërë publike edhe në faqen zyrtare të institucionit.			
<b>Kriteri 4.</b> Institucioni ndjek procedura rekrutimi dhe vlerësimi, mbështetur në kritere të përgjithshme dhe specifike të shpallura e që garantojnë përzgjedhjen e personelit me nivelin e duhur të kualifikimit dhe në përputhje me natyrën, strukturën, modulet dhe përmbajtjen e programit të studimit.	Për përmbushjen e këtij kriteri GVJ konsultoi fillimisht RVB ku thuhet se: Institucioni ndjek një politikë të qartë për rekrutimin e stafit me kualifikimin e duhur. Procesi i rekrutimit të stafit bazohet në dispozitat e parashikuara në Procedurat për Rekrutimin e Stafit të Universitetit dhe realizohet nga Zyra e Burimeve Njerëzore. Procesi i rekrutimit mbështetet në nevojat për personel, të cilat i paraqiten Zyrës së Burimeve Njerëzore nga departamenti. GVJ gjykon që kjo procedurë garanton rekrutimin e personelit me nivelin e duhur të kualifikimit dhe në përputhje me natyrën, strukturën, modulet dhe përmbajtjen e Programit të Studimit.			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				<b>X</b>


#### Standardi IV.2

**Institucioni i arsimit të lartë ka përgjegjësinë primare për cilësinë e personelit që mbulon programin e studimit dhe mbështetjen për kryerjen e detyrave në mënyrë eficiente dhe efektive**

<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni angazhohet për krijimin e mjedisit dhe mundësive të përshtatshme dhe të barabarta për kryerjen e detyrave të personelit në mënyrë profesionale.	Gjatë vizitës në institucion, GVJ vizitoi ambientet e Institucionit. Ai i gjeti këto ambiente të përshtatshme dhe shumë funksionale për kryerjen e detyrave mësimore e kërkimore shkencore. Kjo u pohua edhe nga pjesëtarët e personelit në takimin që GVJ organizoi me ta.



<p><b>Kriteri 2.</b> Institucioni angazhohet për kualifikimin e vazhdueshëm dhe zhvillimin e mëtejshëm profesional të personelit që mbulon dhe administron programin e studimit.</p>	<p>Referuar RVB, GVJ konstaton që Universiteti "POLIS" organizon vazhdimisht trajnime për stafin e tij akademik me qëllim aftësimin profesional të stafit. Gjithashtu, stafi akademik inkurajohej për të marrë pjesë në projekte të shkëmbimit të stafit "Erasmus+" me universitete të tjera partnere. Anëtarë të stafit u shprehën se nëpërmjet këtyre pjesmarrjeve ata kanë shkëmbyer përvoja dhe janë njohur me politikat e menaxhimit dhe strategjitë e zhvilluara në institucionet ndërkombëtare të arsimit të lartë në Europë dhe jashtë saj.</p>			
<p><b>Kriteri 3.</b> Institucioni organizon programe specifike për metodat inovative të mësimdhënies e përdorimit të teknologjive të reja, për kualifikimin e mëtejshëm profesional të personelit akademik e të personelit mësimor-shkencor.</p>	<p>GVJ konstaton se në Universitetin POLIS trajnimet e stafit përbëjnë një pjesë solide të Planit Strategjik. Këto trajnime synojnë zhvillimin e mëtejshëm të metodave të mësimdhënies dhe përdorimit të teknologjive të reja nga ana e personelit akademik.</p> <p>Në takimin me antarë të personelit akademik, GVJ konstatoi se personeli akademik ishte shume i motivuar në përfshirjen e metodave të reja dhe softwareve më të avancuar në fushën e Inxhinierisë së Ndërtimit.</p>			
<p><b>Kriteri 4.</b> Institucioni dëshmon një angazhim optimal të burimeve njerëzore për përmbushjen e objektivave të programeve të studimeve të ciklit të parë.</p>	<p>GVJ konstaton që institucioni dëshmon angazhimin e të gjitha burimeve njerëzore në përputhje me aktet ligjore e nënligjore për përmbushjen e objektivave të programeve të studimit Bachelor. Konkretisht, për PS Bachelor në "Inxhinieri Ndërtimi" pedagogët kryesorë të lëndëve të ofruara në kurikulë zotërojnë të paktën kualifikimin "Master i Shkencave" sipas nenit 59, pika 6 të Ligjit Nr. 80/2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë". Po ashtu, sipas CV-ve të tyre ata kanë një përvojë disa vjeçare si Asistentë Akademikë në fushën specifike të lëndës që zhvillojnë. GVJ u informua nga Departamenti i Inxhinierisë së Ndërtimit se ka si qëllim që në një kohë të shkurtër i gjithë stafi akademik të zotërojë të paktën gradën Doktor. Me përmbushjen e këtij objekti departamenti synon rritjen e cilësisë së mësimdhënies dhe aktivitetit shkencor.</p>			
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				<p><b>X</b></p>



**Standardi IV.3**

**Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion mjedise mësimore dhe infrastrukturën e përshtatshme për realizimin e procesit mësimdhënës të programeve të studimit dhe për formimin praktik, të posaçme sipas natyrës dhe fushës së programit/eve të studimit**

<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni siguron mjediset e mjaftueshme dhe të përshtatshme mësimore për zhvillimin e veprimtarisë mësimdhënëse teorike, në varësi të numrit të studentëve, grupeve mësimore, në përputhje me natyrën specifike të programit të studimit dhe moduleve përkatëse.</p>	<p>Bazuar në RVB si dhe gjatë vizitës në institucion GJV konstaton që Universiteti Polis vë në dispozicion ambiente shumë të përshtatshme për zhvillimin e veprimtarisë mësimdhënëse duke marrë në konsideratë numrin e studentëve dhe natyrën specifike të PS. Auditorët, laboratorët e informatikes, biblioteka dhe mjediset ndërmjetëse. Studentët kishin akses për t'i përdorur si ambientet ashtu edhe teknologjinë mësimore të vendosur në këto ambiente sipas nevojës.</p> <p><i>Zgjerimi i rrjetit aktual të laboratorëve me një laborator të testimit të materialeve të ndërtimit do të ishte një kontribut shumë i rëndësishëm në rritjen e mëtejshme të cilesisë së programit.</i></p> <p><i>(Ref: Aneks 42)</i></p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Mjediset, mësimore si klasa, laboratorë, studio e mjedise të tjera, janë të pajisura me pajisje elektronike dhe të teknologjisë së informacionit, që garantojnë realizimin e procesit mësimor teorik e praktik, përmes përdorimit të metodologjive e teknologjive bashkëkohore të mësimdhënies-mësimnxënies.</p>	<p>Gjatë vizitës në ambientet mësimore të institucionit GJV konstatoi se mjediset mësimore ishin të pajisura me pajisjet e nevojshme të teknologjisë së informacionit si: kompjutera, projektues, internet me kabull dhe wifi. Po ashtu laboratorët e ndryshëm si FAB-Lab ishte i pajisur me pajisje të teknologjisë së fundit. Edhe laboratorët e lëndëve plotësuese si informatikës apo gjuhëve të huaja ishin të pajisur me të gjitha pajisjet dhe softet për zhvillimin e procesit mësimor konform programit. <b><i>GJV rekomandon rritjen e mëtejshme e kapaciteteve laboratorike me një laborator të testimit të materialeve të ndërtimit.</i></b></p> <p><i>(Ref: Aneks 42)</i></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Laboratorët, studiot, atelietë apo mjediset e tjera, sipas natyrës specifike të programit, përmbajnë aparaturat dhe mjetet e nevojshme e të përshtatshme për plotësimin e kërkesave të moduleve, aftësimin teorik e praktik dhe të objektivave formues të programit të</p>	<p>GJV konstatoi që për programin e studimit Bachelor në "Inxhinieri Ndërtimi" institucioni kishte vënë në dispozicion të procesit mësimor e kërkimor 3 laboratorë kompjuterikë. Në të gjitha mjediset laboratorike ishin instaluar pajisjet e duhura dhe softet e përshtatshme në përputhje me realizimin e të gjitha objektivave të procesit mësimor e kërkimor shkencor.</p>


studimit në tërësi.	GVJ u informuar dhe konstatoi përdorimin e Shërbime Mësimore si platforma Tumitin për kontrollin e plagjiatures, platformën Google Classroom, komunikimin e informacioneve në shërbim të programit e ane të emailit etj. Si dhe një sërë softwaresh si psh (BIM, Revit, AutoCAD etj) të nevojshëm për një proces mësimor efektiv.		
<b>Kriteri 4.</b> Institucioni, siguron së paku një laborator të teknologjisë së informacionit, të pajisur me programe profesionale sipas natyrës së programit/ eve të studimit që ofron.	Në universitetin POLIS, GVJ gjeti 3 laboratore të teknologjisë së informacionit të paisura me programe profesionale të cilat ofronin shërbime sipas kërkesave specifike të programit. Shërbimet bazë janë përmendur më lart.		
<b>Kriteri 5.</b> Institucioni garanton, me kapacitetet që zotëron dhe/ose në bashkëpunim me institucione dhe subjekte të tjera, që mjediset të jenë të mjaftueshme, të përshtatshme dhe të posaçme për zhvillimin e praktikave profesionale dhe veprimtarive të tjera praktike.	Referuar RVB si dhe vizitës në institucion, GVJ konstaton se për institucioni ofron mjedise të mjaftueshme dhe të përshtatshme për zhvillimin e praktikave si dhe të aktiviteteve të tjera. Në këto ambiente konkretizohen njohuritë teorike dhe zhvillohen aftësitë praktike të studentëve. Studentët u shprehën se ndjeheshin komod në mjediset ku kryenin aktivitetin praktik. GVJ konstatoi që universiteti kishte marrëveshje me kompani dhe laboratore të provave të inxhinierise se ndertimit për të zhvilluar praktikën në terren dhe provat laboratorike të nevojshme.		
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<input checked="" type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
			<b>X</b>

#### Standardi IV.4

**Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve mjedise mbështetëse të mësimnxënies, bibliotekën, mjedise të posaçme të mësimnxënies dhe literaturën e nevojshme në mbështetje të procesit të mësimnxënies për studentët e programit të studimit**


Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni vë në dispozicion të studentëve bibliotekën mësimore, duke garantuar mundësinë e shfrytëzimit në mënyrë të barabartë nga studentët e programit të studimit.	Referuar RVB dhe vizitës në institucion GVJ raporton që Universiteti POLIS vë në dispozicion të studentëve Bibliotekën mësimore me një sipërfaqe prej rreth 155 metra katrorë dhe një fond prej 10185 librash kryesisht të fushes së shkencave të ndertimit. Kjo bibliotekë kishte një fond të madh librash të skeduar dhe të moduluar sipas programeve të studimit që ofron institucioni. Biblioteka

	ofronte si shërbimin me personel te gatshëm për t'i ndihmuar të interesuarit për të gjitha shërbimet.			
<b>Kriteri 2.</b> Biblioteka duhet të jetë e pajisur me literaturë fizike, si: tekste mësimore bazë, literaturë ndihmëse, e mjaftueshme në gjuhë shqipe dhe të huaja, libra apo revista shkencore të nevojshme, të mjaftueshme dhe e përshtatshme për mbulimin e të gjitha moduleve e veprimtarive mësimore sipas natyrës e specifikës së programit të studimit.	Gjatë vizitës në institucion dhe konkretisht në ambientet e bibliotekës ku dhe u zhvilluan pjesa me e madhe e takimeve GVJ konstatoi që ajo ishte e paisur me literaturë fizike: tekste mësimore bazë, literaturë në gjuhën shqipe dhe të huaj, libra dhe periodikë të ndryshëm të shkruar dhe elektronikë si L'ARCA, Detail, Modulo, Domus etj. Gjithashtu dhe studentët u shprehen të kënaqur me shërbimin e bibliotekës.			
<b>Kriteri 3.</b> Institucioni duhet të krijojë kushte për akses të barabartë e pa pagesë për studentët në bibliotekat on-line të fushës së programit të studimit.	GVJ konstatoi se krahas bibliotekës fizike, Institucioni ofronte akses edhe në tre biblioteka online si: <ul style="list-style-type: none"> <li>• Biblioteken online JSTOR me një numër të gjere materialesh digjitale, tre volume të Alts &amp; Science Volumes dhe një koleksion me 600 revista.</li> <li>• EBSCO mundësuar nga bashkëpunimi me Rrjetin Akademik Shqiptar.</li> <li>• Dhe bibliotekën online të vënë në dispozicion të kërkuesve shkencor nëpërmjet bashkëpunimit me Universitetin e Ferrarës.</li> </ul>			
<b>Kriteri 4.</b> Biblioteka duhet të jetë e pajisur me programe kompjuterike dhe pajisje të tjera teknike që mundësojnë shfrytëzimin pa kufizime nga ana e të gjithë studentëve.	GVJ konstatoi se Biblioteka e Universitetit POLIS ishte e pajisur me kompjutera dhe programet kompjuterike te nevojshme. Po kështu edhe aksesimi në fondin fizik të bibliotekës realizohej me anën e kompjuterave nëpërmjet programit të dizenuar për këtë qëllim			
<b>Kriteri 5.</b> Institucioni duhet të hartojë e zbatojë një plan të detajuar për shtimin e zërave të bibliotekës, përditësimin e fondit ekzistues në mbështetje të programit.	Gjate vizites ne institucion GVJ mesoi se Institucioni u ben thirrje personelit dhe pasuron fondin e bibliotekes çdo vit akademik me materiale cilësore dhe bashkëkohore në ndihmë të studentëve dhe personelit.			
<b>Kriteri 6.</b> Biblioteka duhet të vihet në dispozicion të studentëve në orare shërbimi që janë në përshtatje me oraret e zhvillimit të procesit mësimor dhe përtej tyre, në përgjigje edhe të nevojave, numrit të studentëve dhe kapacitetit të saj.	GVJ u informua dhe gjeti se Biblioteka e Universitetit POLIS siguron akses në informacion, dhe krijimin e një mjedisi të përshtatshëm për studentet dhe stafin. Biblioteka ofronte shërbimet e saj ne oraret: 8:30—16:30 nga e Hëna në të Premte 9:00—17:00 e Shtunë, e Dielë.			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Niveli i përmbushjes</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				<b>X</b>

Two blue ink signatures are present at the bottom of the page. The first signature is a complex, stylized scribble. The second signature is a more fluid, cursive-style scribble.



<b>Standardi IV.5</b>	
<b>Institucioni i arsimit të lartë disponon një sistem të brendshëm të menaxhimit institucional dhe e vë atë në dispozicion të administrimit, informimit dhe monitorimit të aktivitetit akademik, financiar e administrativ për programet e studimit</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni disponon sistem të menaxhimit nëpërmjet të cilit administrohet të gjithë informacionin që lidhet me studentët dhe aktivitetin e tyre nga regjistrimi deri në diplomim në programin e studimit.	GVJ konstatoi se institucioni kryen menaxhimin e të dhënave me anë të platformes "Pitagora". Të gjitha zyrat brenda institucionit kanë akses në informacionin për studentet, statusin e tyre dhe ti ndjekjen në vazhdimësi të studimeve të tyre deri në diplomim. Që në momentin e regjistrimit, studentet pajisen me kredencialet për të aksesuar sistemin, dhe me emailt institucionale. Institucioni mbante dosjet e studentëve në sekretarinë mësimore në menyrë fizike dhe digjitale.
<b>Kriteri 2.</b> Sistemi i brendshëm i menaxhimit administrohet informacionin, dokumentacionin dhe aktivitetin e personelit akademik, personelit ndihmës akademik, personelit administrativ dhe partnerëve të angazhuar në realizimin e programit.	Në lidhje me përmbushjen e këtij kriteri GVJ u informua se përdoret i njëjti sistem menaxhimi. Ky sistem u mundëson personelit akademik, ndihmës akademik, administrative dhe partnerëve aksesim funksional për të menaxhuar aktivitetin e tyre në kuadrin e aktivitetit të përgjithshëm të institucionit.
<b>Kriteri 3.</b> Sistemi i menaxhimit siguron akses të dedikuar në informacione e dokumente për të gjithë personelin dhe studentët e programit të studimit.	GVJ konstatoi që sistemi i sipërpermendur siguron akses të dedikuar. Duke qenë se informacioni ruhet në një bazë qendrore të dhënash edhe stafi edhe studentët kanë akses në informacionin e tyre personal dhe atë që lidhet me programin e studimit. Gjatë vizitës në institucion GVJ u njoh me mënyrën e funksionimit të këtij sistemi dhe konkludon që ai është mjaft i dobishëm për informimin, organizimin dhe planifikimin e aktiviteteve si të studentëve ashtu edhe të stafit aktiv në programin e studimit Bachelor në "Inxhinieri Ndërtimi".
<b>Kriteri 4.</b> Sistemi i menaxhimit ka të integruara platforma dhe module që mundësojnë forma të komunikimit interaktiv dhe shkëmbimit të informacionit ndërmjet personelit dhe studentëve.	Lidhur me përmbushjen e këtij kriteri GVJ u informua se sistemi i menaxhimit i sipërpermendur mundësojnë forma të komunikimit interaktiv dhe shkëmbimit të informacionit ndërmjet personelit dhe studentëve.
<b>Kriteri 5.</b> Sistemi i menaxhimit garanton monitorim në kohë reale të aktivitetit akademik e administrativ dhe mundëson raportime individuale dhe të dhëna	GVJ konstatoi që sistemi garanton monitorim në kohë reale të aktivitetit akademik e administrativ dhe mundëson raportime individuale dhe të dhëna në kohë reale për organet drejtuese dhe titullarët. Kështu nëpërmjet tij



në kohë reale për organet drejtuese dhe titullarët.	monitorohet frekuentimi i studentëve, llogaritet nota përfundimtare, njoftohet stafi akademik dhe administrativ për të drejtën e hyrjes në provim të studentëve etj. Ky sistem automatizon edhe procesin e plotësimit të kërkesave të studentëve për dokumenta të caktuara duke inicuar dhe ndjekur procesin deri në fund.			
<b>Kriteri 6.</b> Informacionet që lidhen me programet e studimit, personelin akademik, aktivitetet e ndryshme, publikohen në faqen e internetit në të paktën dy gjuhë ku të paktën njëra prej tyre është gjuha shqipe.	Për përmbushjen e këtij kriteri GVJ konsultoi faqen zyrtare në internet të institucionit dhe gjeti që informacionet të cilat lidhen me programet e studimit, personelin akademik dhe aktivitetet e tjera të Universitetit POLIS publikohen në faqen e internetit në shqip dhe në anglisht.			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				<b>X</b>

#### Standardi IV.6

**Institucioni i arsimit të lartë garanton financimin dhe mbështetjen financiare të nevojshme për realizimin e procesit mësimor-kërkimor, mbarëvajtjen e programit të studimit dhe mbështetjen e studentëve.**

<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni harton një raport financiar të kostove të programit të studimit dhe planin për mbështetjen financiare të nevojshme për mbarëvajtjen e programit të studimit për të paktën një cikël të plotë studimi.	GVJ konstaton që Universiteti POLIS ka buxhet të pavarur dhe harton një raport financiar të kostove të programit të studimit dhe planin për mbështetjen financiare të nevojshme për mbarëvajtjen e tij për cikël të plotë studimi. Buxheti mer parasysh kërkesën dhe nevojën për burime njerëzore akademike dhe administrative në shërbim të programit, burimet infrastrukturore, logjistike dhe didaktike si dhe investime afatgjata ku përfshihen pajisje për klasat, laboratore dhe investime të tjera.
<b>Kriteri 2.</b> Plani i financimit të një programi studimi duhet të përmbajë financimin e burimeve njerëzore në shërbim të realizimit të programit, shpenzimet operative për mirëmbajtjen e mjediseve dhe teknologjive mbështetëse të procesit mësimor, shpenzimet për bibliotekën dhe pasurimin e literaturës e aksesin në bibliotekat on-line, detyrimet financiare, grantet vendëse apo të huaja të përfituara dhe kontratat e shërbimeve të lidhura në funksion	Gjatë vizitës në institucion GVJ u informua edhe lidhur me financimin e burimeve njerëzore në shërbim të realizimit të programit, shpenzimet operative për mirëmbajtjen e mjediseve dhe teknologjive mbështetëse të procesit mësimor, shpenzimet për bibliotekën dhe pasurimin e literaturës e aksesin në bibliotekat online, detyrimet financiare, grantet vendëse dhe të huaja të përfituara dhe kontratat e shërbimeve të lidhura në funksion të realizimit të programit të studimit. Nga ky informacion ai mësoi që burimi kryesor i financimit ishin të ardhurat nga tarifat e studentëve ndërsa fondet e tjera lidheshin me të ardhurat

Adresa: "Rruga e Durrësit", Nr. 219 Tiranë

E-mail: info@ascal.al

Tel:+355 (04) 22-43423

Web site: [www.ascal.al](http://www.ascal.al)

Faqe 50

të realizimit të programit të studimit dhe zëra të tjerë sipas natyrës specifike të tij.	nga projektet kombëtare dhe ndërkombëtare. Shpërndarja e këtyre fondeve bëhet nga Zyra e Financave bazuar në zërat e miratuara në buxhet.			
<b>Kriteri 3.</b> Institucioni kryen auditim të përvitshëm, vlerëson dhe dokumenton gjendjen e financimit dhe efektivitetin financiar të tij. Raporti financiar përmban një pasqyrë të hollësishme financiare të të ardhurave nga tarifat e shkollimit dhe kontributeve të tjera financiare për studentët ose ndarjen e burimeve financiare.	GVJ mesoi se Institucioni kryen cdo vit auditimin e pasqyrave financiare nga një kompani e mirënjohur ndërkombetare e cila konfirmon vërtetësinë dhe pasqyrimin drejtë informacionit financiar. GVJ konkludon se instiucioni zotëron burimet e nevojshme financiare për ta mbështetur këtë Program Studimi.			
<b>Kriteri 4.</b> Në mbyllje të çdo cikli të plotë studimi, institucioni dokumenton raportet financiare për tri vitet e kaluara akademike dhe planifikon ndërhyrjet e posaçme dhe diversifikimin eventual të financimit të programit për të garantuar ecurinë dhe mbarëvajtjen normale të tij.	GVJ konstaton që ky kriter përmbushet, bazuar ne raportimet e bera me siper.			
<b>Kriteri 5.</b> Institucioni duhet të dëshmojë se garanton qëndrueshmërinë financiare përgjatë kohës së zhvillimit të programit të studimit dhe se ka kapacitete financiare të mjaftueshme për përmirësimin e situatës financiare dhe gjenerimin e të ardhurave të domosdoshme në të ardhmen.	Bazuar ne raportet fiaciare GVJ konstaton se institucioni ka bilanc financiar pozitiv, çfarë garanton qëndrueshmërinë financiare përgjatë kohës së zhvillimit të programit të studimit dhe ekzistencën e kapaciteteve financiare të mjaftueshme për përmirësimin e situatës financiare në të ardhmen. (Ref: Aneks 49)			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				<b>X</b>

<b>Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës IV</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				<b>X</b>

## V. STUDENTËT DHE MBËSHTETJA E TYRE

<b>Standardi V.1</b>	
<b>Institucioni i arsimit të lartë harton, ndjek dhe zbaton politika dhe procedura për pranimin, përzgjedhjen, përparimin e studentëve, transferimin, njohjen, vlerësimin e dijeve dhe diplomimin në programin e studimit</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni harton dhe zbaton politika dhe procedura që mbulojnë ciklin e plotë akademik të studentëve nga hyrja në dalje, në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe aktet e veta rregullatore.</p>	<p>Referuar RVB dhe gjetjeve nga vizita në institucion, GVJ është informuar mbi politikat dhe procedurat që mbulojnë ciklin e plotë akademik të studentëve nga hyrja në dalje. GVJ konstaton se ne Rregulloren Didaktike të institucionit përkruhen procedurat e pranimit të studentëve si: dispozitat e përgjithshme, aplikimi, transferimi, etj. Këto politika dhe procedura janë hartuar në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe aktet rregullatore të institucionit.</p> <p><i>(Ref: Aneks 9)</i></p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Politikat dhe procedurat nga hyrja në dalje, garantojnë barazinë dhe të drejta të njëjta për të gjithë kandidatët për studentë dhe studentët e programit të studimit.</p>	<p>Në shqyrtimin e politikave dhe procedurave për pranimin, edukimin dhe diplomimin e studentëve, GVJ gjykon që ato garantojnë barazinë dhe të drejta të njëjta për të gjithë kandidatët për studentë dhe studentët e programit të studimit. Të gjithë ata që kanë aplikuar për programet e studimit në Universitetin POLIS dhe fitojnë të drejtën e studimit rregjistrohen si studentë zyrtarë dhe u nënshtrohen njëlloj të drejtave dhe detyrimeve që lindin nga ky status. GVJ konstaton që në këtë institucion, si të drejtat ashtu edhe detyrimet janë të njëjta për të gjithë studentët që nga momenti kur marrin statusin e studentit deri kur diplomohen.</p> <p><i>(Ref: Aneks 7)</i></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Kriteret, procedurat e pranimit e përzgjedhjes së studentëve, përparimit përgjatë kursit të studimit, të transferimit, njohjes së studimeve të mëparshme ose të pjeshme, të vlerësimit të dijeve dhe të diplomimit janë lehtësisht të kuptueshme dhe të aksesueshme nga publiku.</p>	<p>Bazuar në RVB; GVJ gjykon se procedurat e pranimit, përzgjedhjes së studentëve, ato të përparimit përgjatë kursit të studimit, të transferimit, njohjes së studimeve të mëparshme ose të pjeshme, të vlerësimit të dijeve dhe të diplomimit ato janë të aksesueshme dhe të kuptueshme nga publiku. Procedurat deri në rregjistrim janë procedura konkurruese të cilat gjenden në faqen zyrtare të universitetit.</p> <p><i>(Ref: Aneks 7)</i></p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kriteret të veçanta për përzgjedhjen e kandidatëve, për t'u pranuar në ciklin e parë të studimeve.</p>	<p>Gjate takimit në zyrën e pranimit, GVJ konstatoi se institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kriteret të veçanta për përzgjedhjen e kandidatëve, për t'u pranuar në ciklin e parë të studimeve.</p>


Adresa: "Rruga e Durrësit", Nr. 219 Tiranë

E-mail: [info@ascal.al](mailto:info@ascal.al)

Tel: +355 (04) 22-43423

Web site: [www.ascal.al](http://www.ascal.al)

Faqe 52




<p><b>Kriteri 5.</b> Kriteret e përgjithshme dhe ato specifike hartohen dhe zbatohen në përputhje me aktet nënligjore të ministrisë përgjegjëse për arsimin, si dhe në maturën shtetërore. Kriteret parashikojnë edhe regjistrimin e studentëve të huaj.</p>	<p>Lidhur me procedurat dhe kriteret e pranimit të studentëve në programin Bachelor në Inxhinieri Ndërtimi, GVJ konstaton se ato janë në përputhje me aktet nënligjore dhe maturën shtetërore, gjithashtu janë të përcaktuara edhe në Rregulloren e Programit, faqen zyrtare të POLIS, gjithashtu. GVJ u informua se ato janë publike dhe përditësohen çdo vit akademik sipas legjislacionit në fuqi.</p>			
<p><b>Kriteri 6.</b> Përpara fillimit të çdo viti akademik, institucioni udhëzon publikun dhe të interesuarit në lidhje me kërkesat e kriteret e përgjithshme e të veçanta të programit të studimit.</p>	<p>GVJ u informua që udhëzimin e publikut dhe të interesuarve në lidhje me kërkesat e kriteret e përgjithshme e të veçanta të programit të studimit, në ambientet e universitetit e organizon dhe e kryen Zyra e Pranimeve. Nga kjo zyre kandidatet mund të marrin informacion të detajuar për universitetin dhe programin specifik të studimit. Gjithashtu të interesuarit mund t'i konsultojnë kriteret e pranimit dhe të drejtat e detyrat e tyre si studentë në faqen zyrtare të institucionit.</p>			
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				<p>X</p>

### Standardi V.2

**Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve të programit të studimit, informacion të plotë e të hollësishëm mbi përparimin akademik, njohjen, vlerësimin e dijeve deri në përfundim të studimeve dhe diplomimit në atë program**

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni vë në dispozicion informacion të plotë dhe të hollësishëm në lidhje me kriteret e procedurat e përparimit akademik të studentëve dhe kalimit nga një vit akademik në tjetrin.</p>	<p>GVJ konstatoi se Universiteti POLIS informon studentët në lidhje me kriteret, procedurat e përparimit akademik të tyre, në lidhje me programin e studimit dhe procesin mësimor me anë të disa burimeve të informacionit. Një pjesë të informacionit studentët e gjejnë në Statutin e institucionit, rregulloret, procedurat në lidhje me aktivitete të ndryshme të procesit mësimor, etj te cilat mund ti aksesojnë elektronikisht ose fizikisht. Ndersa informacionin në lidhje me ecurinë e tyre personale e aksesojnë nëpërmjet sistemit PITAGORA. Te njejtet gje e konfirmuan dhe studentet gjate takimit me ta.</p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e njohjeve të kualifikimeve të mëparshme ose studimeve të pjesshme.</p>	<p>GVJ konsultoi RVB dhe, gjatë vizitës në institucion, mësoi për punën që bëhet në informimin e studentëve lidhur me kriteret e procedurat e njohjeve të kualifikimeve të mëparshme ose studimeve të pjesshme. Në këtë kuadër konstatohet që sipas direktivave dhe rregulloreve çdo student, informohet rregullisht për procedurat dhe afatet e</p>



	njohjes së diplomës së studimeve të mëparshme. Studentët gjithashtu informohen për njohjen e diplomës bazuar në akreditimin e programit të studimit.			
<b>Kriteri 3.</b> Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e vlerësimit të dijeve e aftësive të studentëve në programin e studimit.	GVJ konstaton që në Universitetin POLIS studentët informohen rregullisht në lidhje me kriteret e procedurat e vlerësimit të dijeve e aftësive të studentëve në programin e studimit. Ky konstatim konfirmohet si nga gjetjet në RVB ashtu edhe informacionet nga vizita në institucion. Përveçse në dokumentacionin ligjor të Universitetit kriteret dhe procedurat e vlerësimit jepen edhe në syllabuset e lëndëve.			
<b>Kriteri 4.</b> Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e punimit të diplomës dhe diplomimit në programin e studimit.	Edhe në lidhje me këto kriter GVJ konstatoi se informacioni që i percillet studentëve është i plotë dhe i qartë. Pasi sic është shpjeguar në hollësi dhe në Standartin III.8. Gjatë gjithë periudhës së punimit të diplomës studentet janë të mbikëqyrur dhe të udhëhequr nga një grup pedagogesh që monitorojnë dhe mbështesin studentin gjatë këtij procesi.			
<b>Kriteri 5.</b> Përpara fillimit të çdo viti akademik dhe në mënyrë periodike, institucioni publikon udhëzues të posaçëm dhe organizon takime të hapura për informimin e të interesuarve dhe studentëve të ardhshëm mbi programin e studimit.	Bazuar në informacionin e paraqitur në RVB si dhe gjatë takimeve në Universitetin POLIS, GVJ konstaton se institucioni informon të interesuarit apo studentet e ardhshëm të këtij programi nëpërmjet faqes zyrtare dhe mediave sociale, ku publikon informacionet me të përditësuara lidhur me programin. Nderkohe, Zyra e Pranimeve dhe Departamenti organizojnë takime të hapura me inaturantët e gjimnazeve të interesuar për këtë program studimi. Gjithashtu Universiteti publikon udhëzues në formën e broshurave për të informuar studentet e ardhshëm në lidhje me aspekte të ndryshme të këtij programi studimi (Ref: Aneks 51)			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>		<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				<b>X</b>

### Standardi V.3

**Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve informacion të plotë e të hollësishëm për objektivat formuese, strukturën, organizimin, përmbajtjen e programit të studimit, rezultatet e pritshme të të nxënit dhe mundësitë e punësimit**

<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Studentët informohen në mënyrë të hollësishme për strukturën, organizimin dhe kohëzgjatjen e programit të studimeve.	GVJ konstaton që informimi i studentëve për strukturën, organizimin dhe kohëzgjatjen e programit të studimeve Bachelor në "Inxhinieri Ndërtimi" janë të aksesueshme në faqen e Universitetit. Gjithashtu Departamenti organizon

	takime orientuese per te informuar studentet ne lidhje me: pëmbajtjen e programit të studimit, për lëndet, ngarkesën mesimore, frekuentimi, syllabuset e detajuara, materialet mesimore, oraret, datat e provimeve, objektivat e kurseve, sistemin e vlerësimit etj.			
<b>Kriteri 2.</b> Institucioni vë në dispozicion të studentëve të programeve të studimit informacion dhe dokumentacion/udhëzues të posaçëm për modulet, lëndët, pëmbajtjen dhe veprimtaritë formuese.	Nëpërmjet RVB dhe vizitës në Institucion GVJ u informua mbi Kurikulën dhe syllabuset e lëndëve të programit të studimeve Bachelor në “Inxhinieri Ndërtimi”. Këto materiale u vihen në dispozicion në fillim të çdo viti studentëve të këtij programi studimi. Kjo bën që ata të jenë të mirëinformuar për modulet, lëndët, pëmbajtjen dhe veprimtaritë formuese.			
<b>Kriteri 3.</b> Institucioni informon studentët mbi mundësitë e punësimit, si dhe mbështetjen institucionale për orientimin drejt e në tregun e punës.	GVJ konstaton se përbushja e këtij kriteri realizohet nëpërmjet aktivitetit të Zyres së Mbeshtetjes së Studenteve dhe Keshillimit të Karrierës. Referuar RVB, kjo zyrë i orjenton dhe i mbështet studentet në krijimin e dokumentacionit sa më të përshtatshëm për të konkuruar në tregun e punës. Zyra ndërmjetëson kontaktet dhe i finalizon ato.			
<b>Kriteri 4.</b> Studentëve u vihet në dispozicion informacion i gjerë dhe i përditësuar mbi zhvillimin dhe organizimin e procesit mësimor, logjistikën, infrastrukturën dhe shërbimet në funksion të realizimit të tij.	Në Universitetin POLIS studentët e marrin informacionin mbi zhvillimin e procesit mësimor të plotë dhe të përditësuar. GVJ konstaton se studentët i konsultojnë të gjithë burimet e informacionit. Në takimin me ta, studentët demonstuan njohje të plotë të informacionit mbi procesin mësimor, logjistikën, infrastrukturën dhe shërbimet.			
<b>Kriteri 5</b> Informacioni në lidhje me programin e studimit mundësohet përmes sistemit të menaxhimit të brendshëm të informacionit dhe duhet të jetë lehtësisht i arritshëm nga studentët edhe në distancë.	GVJ konstaton që informacioni në lidhje me programin e studimit bachelor në “Inxhinieri Ndërtimi” është i plotë në Platformën “PITAGORA” e cila njihej mirë nga studentët dhe përdorej në çdo kohë e lehtësisht prej tyre pavarësisht nga distanca.			
<b>Shkalla e përbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përbushet</b>	<b>Përbushet pjesërisht</b>	<b>Përbushet kryesisht</b>	<b>Përbushet plotësisht</b>
				<b>X</b>

#### Standardi V.4


**Institucioni i arsimit të lartë mbledh, administron, përditëson dhe ruan të dhëna të hollësishme në lidhje me numrin e profilin e studentëve që ndjekin programet e studimeve të ciklit të parë, nga pranimi në diplomim, si dhe të dhëna të punësimit të tyre përmes një sistemi menaxhimi informatik të brendshëm**

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni disponon dhe mban statistika vjetore për numrin e	GVJ konstaton se Institucioni disponon te gjithe

<p>studentëve e të diplomuarve për çdo program studimi.</p>	<p>informacionin ne lidhje me studentët e regjistruar, larguar, diplomuar dhe të dhëna të tjera statistikore te cilat mbahen nga Sekretaria Mësimore në bazë të formateve të përcaktura nga MAS, si ne Rregulloren e Përgjithshme dhe Rregulloren Didaktike te Universitetit.</p> <p>Institucioni i ruan këto informacione në format elektronik ashtu dhe në regjistra si: Regjistri i Procesit Mësimor, Regjistri i Notave, Regjistri Themeltar dhe Regjistri i Diplomave të cilat arkivohen në fund të çdo semestri.</p>			
<p><b>Kriteri 2.</b> Institucioni disponon statistika vjetore për numrin e studentëve të regjistruar në programet e studimeve të ciklit të parë, tërheqjet nga programi, si dhe largimet para përfundimit të programit apo mospërfundimin me sukses të vitit akademik në të cilin zhvillohet programi i studimeve.</p>	<p>GVJ konstaton që institucioni disponon statistika vjetore për numrin e studentëve të regjistruar në programet e studimeve të ciklit të parë, tërheqjet nga programi, si dhe largimet para përfundimit të programit apo mospërfundimin me sukses të vitit akademik në të cilin zhvillohet programi i studimeve. Këto statistika ndodheshin ne Sekretarine Mësimore.</p>			
<p><b>Kriteri 3.</b> Institucioni disponon të dhëna për ecurinë e studentëve gjatë zhvillimit të programit të studimeve që nga pranimi deri në diplomimin e tyre.</p>	<p>Gjatë takimit me përfaqësues të Sekretarisë Mësimore GVJ i konsultoi të dhënat për ecurinë e studentëve gjatë zhvillimit të programit të studimeve që nga pranimi deri në diplomimin e tyre. GVJ u informua që, duke filluar nga semestri i parë deri në diplomim, çdo notë e studentëve regjistrohej në kopje fizike dhe kopje elektronike në sistem duke gjeneruar informacion të qartë mbi ecurinë e studentëve dhe performancën e tyre.</p>			
<p><b>Kriteri 4.</b> Të dhënat statistikore të studentëve menaxhohen përmes sistemit të brendshëm të informacionit dhe duhet të jenë të sigurta dhe lehtësisht të verifikueshme nga personat e autorizuar.</p>	<p>Në takimit ne Sekretarine Mesimore GVJ konstatoi se te gjitha te dhenat lidhur me studentët e Programit Bachelor Inxhinieri Ndërtimi ruhen ne menyre te sigurte ne sistemin e brendshem i cili gjeneron automatikisht te gjitha statistikat e kërkuara nga MAS apo institucionet përkatëse. Ky sistem është funksional, i sigurtë dhe të dhënat janë lehtësisht të verifikueshme nga personat e autorizuar.</p>			
<p><b>Kriteri 5.</b> Institucioni duhet të hartojë raporte analitike periodike mbi profilin dhe cilësinë në hyrje dhe dalje të studentëve, si dhe shkallës së cilësisë së punësimit të tyre, duke e shoqëruar me masat e duhura në drejtim të përmirësimit të këtyre treguesve.</p>	<p>Universiteti disponon informacion te plotë në lidhje me studentet e rinj, gjithashtu, harton nje raport pas diplomimit, lidhur me cilesine ne dalje te tyre.</p> <p>Dekani studion kuptimin e rezultateve me qellim orientimin e programit ne formen e duhur per ti ofruar studenteve nje program sa me efikas dhe frytdhenes ne aspektin profesional.</p>			
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>



				<b>X</b>
--	--	--	--	----------




**Standardi V.5**

**Institucioni i arsimit të lartë përfshin dhe angazhon studentët në organet vendimmarrëse e këshilluese, në kuadër të hartimit, miratimit, rishikimit e përmirësimit të programeve të studimit, metodave të mësimdhënies dhe cilësisë së burimeve e shërbimeve ndaj tyre**

<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni parashikon përfshirjen dhe angazhimin e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në organet vendimmarrëse e këshilluese sipas akteve ligjore dhe atyre rregullatore të vetë IAL-ve.</p>	<p>Bazuar ne RVB dhe nga takimet ne institucion GVJ konstaton se angazhimi i studenteve administrohet nga Komisioni i Marredhenieve me Studentet i krijuar bazuar ne nenin 63 te statutit te Universitetit POLIS. Anetaret e komisionit propozohen nga Rektori dhe miratohen nga Senati Akademik per nje mandat dy vjeçar, me te drejte rizgjedhje.</p> <p>Komisioni perbehet nga 5 anetare, perkatesisht: 3 Zevendes Drejtues te njesive kryesore, 1 perfaqesues i stafit akademik dhe 1 perfaqesues i stafit administrativ.</p> <p>Gjithashtu nje perfaqesues i studenteve eshte anetar i senatit akademik.</p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Institucioni duhet të garantojë se përfshirja e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në vendimmarrje, këshillim apo vlerësimin mbi procesin akademik, të jetë reale, konkrete, frutdhënëse dhe me rezultate lehtësisht të verifikueshme e të matshme.</p>	<p>GVJ konstaton që bazuar në Statutin e Universitetit POLIS, studentët përfaqësohen në vendimmarrje, këshillim apo vlerësimin mbi procesin akademik në Universitet, përmes përfaqësuesve të tyre të zgjedhur. Gjithashtu studentet kane nje organ te pavarur qe eshte Keshilli Studentor, I cili promovon dhe koordinon perfaqesimin e studenteve në organet drejtuese të institucionit, në strukturat mësimore-kërkimore dhe të shërbimeve.</p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Në hartimin dhe përmirësimin e programeve të studimit, institucioni duhet të mbajë parasysh ngarkesën akademike të studentëve në programin e studimit dhe parashikimin e procedurave joburokratike të përparimit të studentëve përgjatë programit, përfshirë njohjen e studimeve të plota apo të pjesshme të mëparshme.</p>	<p>Lidhur me përmbushjen e këtij kriteri GVJ konstaton që institucioni e merr parasysh ngarkesën akademike të studentëve në programin e studimit kryesisht gjatë hartimit dhe përmirësimit të programit të studimit si kurikulë dhe si syllabuse. Në takimin me studentët ata u shprehën për konsiderimin e mendimit të tyre dhe se ngarkesa e tyre ishte e përballueshme nqs puna e tyre eshte sistematike.</p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Institucioni garanton përfshirjen e studentëve në procesin e hartimit, rishikimit dhe përmirësimit të programeve të studimit mbi</p>	<p>Institucioni i perfshin studentet ne proceset e hartimit, rishikimet dhe permiresimit te programit nepermjet Keshillit te Studentëve. Studentet u shprehen te kenaqur ne lidhje me vleresimit e propozimeve te tyre nga ana e organeve vendim marrese te institucionit.</p>

baza të rregullta dhe të reflektojnë sugjerimet e kontributin e tyre në to.									
<b>Kriteri 5.</b> Studentëve u mundësohet të japin mendim mbi barazinë dhe ndershmërinë e kryerjes së procesit të vlerësimit e kontrollit të dijeve, përfshirë mundësinë e ankimimit të rezultetit, rishikimit dhe reflektimit nga ana e institucionit/njesisë/pedagogut përgjegjës.	Gjatë takimit të GVJ me studentët ata u shprehën se u është mundësuar të japin mendime mbi barazinë dhe ndershmërinë e kryerjes së procesit të vlerësimit e kontrollit të dijeve si dhe mundësinë e ankimimit të rezultetit, rishikimit të tij dhe reflektimit nga ana e institucionit përkatësisht njesisë dhe pedagogut përgjegjës. Institucioni angazhon njesine baze dhe njesine kryesore per te garantuar te drejtat e studenteve ne keto raste.								
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<table border="1"> <thead> <tr> <th>Niveli i përmbushjes</th> <th>Përmbushet pjesërisht</th> <th>Përmbushet kryesisht</th> <th>Përmbushet plotësisht</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td></td> <td></td> <td></td> <td>X</td> </tr> </tbody> </table>	Niveli i përmbushjes	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht				X
Niveli i përmbushjes	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht						
			X						

<b>Standardi V.6</b>	
<b>Institucioni ka procedura e njësi të posaçme për pritjen, orientimin, këshillimin e studentëve, menaxhimin e ankimimeve e problematikave, të cilat operojnë në mënyrë permanente e janë lehtësisht të arritshme e të përdorshme nga studentët</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni ka procedura e njësi të posaçme në shërbim të informimit e shërbimit të studentëve, në përputhje me parashikimet ligjore dhe aktet rregullatore të IAL-ve.	GVJ konstaton se institucioni mbështet dhe informon studentet nepermjet Zyres se Mbështetjes së Studentëve dhe Këshillimit të Karrierës (ZMSKK) gjatë gjithë periudhës së studimit. Nepermjet kesaj zyre studentet marin informacionet e nevojshme lidhur me rregulloret e ndryshme te institucionit, procesin mësimor, këshillimin për praktikat profesionale etj.
<b>Kriteri 2.</b> Institucioni ka të ngritur dhe funksional një sistem të posaçëm për informimin, këshillimin, ndjekjen e përparimit të studentëve dhe asistimin e tyre për çështje që kanë të bëjnë me procesin mësimor dhe programin e studimit.	Edhe për përmbushjen e këtij kriteri GVJ mësoi që në Universitetin POLIS është ngritur dhe funksionon infrastruktura e posaçme organizative dhe logjistike.
<b>Kriteri 3.</b> Institucioni u ofron studentëve shërbimin e këshillimit të karrierës. Zyra/njësia për këshillimin e karrierës mirëpret studentët në mënyrë të vazhduar dhe periodike, duke ofruar informacion dhe orientim të posaçëm, në lidhje me kompletimin e procesit mësimor, zgjedhjen dhe orientimin për praktikën	GVJ konstatoi që në Universitetin POLIS, Zyra e Mbështetjes se Studenteve dhe Këshillimit të Karrierës kryen të gjitha shërbimet e këshillimit të karrierës. Duke qenë njësia që mban lidhje të vazhdueshme me kompani te ndryshme. Nga ana tjetër kjo Zyrë mirëpret studentët që ata të informohen lidhur me kërkesat dhe nevojat e tregut të punës. Kjo zyre i ofron studenteve keshillimin dhe orjentimine nevojshem ne lidhje me kryerjen e praktikave



profesionale në institucione të tjera dhe orientimin në tregun e punës.	profesionale dhe orientimin e tyre ne tregun e punes.			
<b>Kriteri 4.</b> Zyra/njësia e karrierës ndjek studentët pas diplomimit, mbledh, përpunon e mban të dhëna mbi shkallën dhe cilësinë e punësimit të studentëve të programit të studimit dhe ua vë ato në dispozicion studentëve dhe organeve e autoriteteve drejtuese përkatëse.	Edhe për përmbushjen e këtij kriteri një rol parësor kishte Zyra e Mbeshtetjes se Studenteve dhe Keshillimit të Karrierës. GVJ u informua që kjo zyrë mblidhte, përpunonte dhe ruante të dhënat mbi shkallën dhe cilësinë e punësimit edhe të studentëve të programit Bachelor në Inxhinieri Ndërtimi. Këto të dhëna ajo ua vinte në dispozicion si studentëve po ashtu edhe organeve e autoriteteve mbështetur në kërkesën e tyre.			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				<b>X</b>

<b>Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës V</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				<b>X</b>

## VI.SIGURIMI I CILËSISË SË PROGRAMEVE TË STUDIMIT BACHELOR

### Standardi VI.1

**Institucioni i arsimit të lartë harton dhe zbaton politika e procedura transparente të posaçme për sigurimin e cilësisë së programeve të studimit në kuadër të strukturave e sistemit të brendshëm të sigurimit të cilësisë**

<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni ka politika, struktura dhe procedura për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë, në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore në fuqi dhe me aktet rregullatore institucionale.	GVJ konstaton se Universiteti POLIS në strukturën e tij, ka një njësi përgjegjëse për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë që funksionon në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore dhe rregulloret e brendshme të institucionit. Ngritja dhe funksionet e Njesisë së Brendshme të Sigurimit të Cilësisë janë të bazuara respektivisht në Statutin e institucionit Rregulloren e Njesisë së Brendshme të Sigurimit të Cilësisë. (Ref: Aneks 2 dhe 8)
<b>Kriteri 2.</b> Institucioni ka të ngritur dhe funksional Sistemin e Brendshëm të Sigurimit të Cilësisë dhe zbaton një strategji institucionale për përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë, ku përfshihen edhe studentët dhe bashkëpunëtorë e ekspertë të	Bazuar në RVB dhe në takimin me anetarët e Njesisë së Brendshme të Sigurimit të Cilësisë GVJ konstaton se NJBSC është një njësi e përhershme e pavarur, e angazhuar në menaxhimin dhe sigurimin e cilësisë në mënyrë të vazhdueshme nëpërmjet krijimit dhe zbatimit të politikave, strategjive dhe procedurave të ngritura për këtë

Adresa: "Rruga e Durrësit", Nr. 219 Tiranë

E-mail: info@ascal.al

Tel:+355 (04) 22-43423

Web site: [www.ascal.al](http://www.ascal.al)

Faqe 60

jashtëm.	qëllim. GVJ konstaton se kjo njësi përbëhet nga 9 anëtarë dhe operon bazuar në rregulloren NJBSC. Drejtues njësisë përzgjidhet nga pedagogët e brendshëm dhe në të bëjnë pjesë përfaqësues të studentëve, të të diplomuarve dhe bashkëpunorë të institucionit nga industria.								
<b>Kriteri 3.</b> Institucioni përdor instrumentet e duhura për sigurimin e cilësisë, Sigurimi i Jashtëm i Cilësisë në arsimin e lartë realizohet përmes proceseve të vlerësimit të jashtëm të akreditimit, vlerësimeve analitike e krahasuese, si dhe proceseve të tjera që promovojnë e përmirësojnë cilësinë.	Universiteiti POLIS përdor Vlerësimin e Performancës Akademike dhe Administrative si dhe metodologji dhe instrumenta për matjen e cilësisë së proceseve akademike. Institucioni nështrohet proceseve të Akreditimit periodik institucional dhe të programeve të studimit. Studentët janë gjithashtu të përfshirë në përgatitjen e Raporteve të Vlerësimit të Brendshëm të përgatitur në kuadër të akreditimit të institucionit dhe programeve të studimit.								
<b>Kriteri 4.</b> Institucioni ka hartuar një politikë të qartë dhe ndjek procedura periodike për sigurimin dhe përmirësimin e cilësisë së programeve të studimeve që ofron, në kuadër të Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë. Ato synojnë krijimin e kulturës së cilësisë në rang institucional, të njëjve përbërëse dhe të gjithë aktorëve të brendshëm të institucionit.	Universiteti ka hartuar Politikën e Cilësisë dhe Politikën për Përmirësimin e Vazhdueshëm të Programeve të Studimit. Kjo politikë synon të sigurojë dhe të përmirësojë cilësinë e programeve të studimit, si dhe për të krijuar një kulturë të cilësisë në nivelin institucional.								
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<table border="1"> <thead> <tr> <th>Përbushet</th> <th>Përbushet pjesërisht</th> <th>Përbushet kryesisht</th> <th>Përbushet plotësisht</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td></td> <td></td> <td></td> <td>X</td> </tr> </tbody> </table>	Përbushet	Përbushet pjesërisht	Përbushet kryesisht	Përbushet plotësisht				X
Përbushet	Përbushet pjesërisht	Përbushet kryesisht	Përbushet plotësisht						
			X						

### Standardi VI.2

**Institucioni i arsimit të lartë monitoron dhe vlerëson përmes njëjve të posaçme e në mënyrë periodike programet e studimit, për të garantuar arritjen e objektivave formuese dhe rezultateve të synuara të të nxënit.**

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni ngrë njësi të posaçme për monitorimin, shqyrtimin, mbikëqyrjen, rishikimin e programeve të studimit të ciklit të parë.	GVJ konstaton se Departamenti është njësi bazë përgjegjëse për mirë funksionimin e programit të studimit dhe për të siguruar cilësinë e saj. Monitorimi dhe rishikimi i programeve të studimit kryhet nga departamentet përkatëse, i cili më pas kalon në filtrin e njësive e monitorimit të kurrikulës dhe miratimin final e mer nga Senati Akademik. (Ref: Aneks 13)
<b>Kriteri 2.</b> Institucioni përdor mekanizma e procese formale e të dokumentuara, për shqyrtimin,	Institucioni posedon mekanizma formale për monitorimin e programeve të studimit si NJBSC, Këshillat e

Adresa: "Rruga e Durrësit", Nr. 219 Tiranë

E-mail: info@ascal.al

Tel:+355 (04) 22-43423

Web site: [www.ascal.al](http://www.ascal.al)

Faqe 61


miratimin dhe mbikëqyrjen e herëpashershme të programeve të studimeve të ciklit të parë.	Fakulteteve, Senati Akademik, Rektorati etj. Me anë të këtyre mekanizmave institucioni kryen mbikëqyrjen periodike të programit të studimit. Procedurat e kontrollit të cilësisë janë të formalizuara në rregulloren përkatëse. <i>(Ref: Aneks 8)</i>								
<b>Kriteri 3.</b> Institucioni përdor metodologji vlerësimi, instrumente matëse dhe vlerësuese për ecurinë dhe mbarëvajtjen e programeve të studimeve.	GVJ konstaton se Universiteti POLIS përdor metodologji vlerësimi dhe instrumente matëse për ecurinë dhe mbarëvajtjen e procesit të mësimdhënies, cilësisë së literaturës së përdorur, teknikave pedagogjike të përdorura nga pedagogët etj. Institucioni kryen vlerësimin e proceseve mesimore në tre forma në mënyrë kumulative si: pyetësorin e studentëve, vlerësimin nga kolegët dhe vetëvlerësimin. NJBSC publikon rezultatet e vlerësimit në Raportin periodik në fund të cdo viti akademik.								
<b>Kriteri 4.</b> Rezultatet e këtyre vlerësimeve dokumentohen dhe u bëhen të njohura autoriteteve përgjegjëse dhe vendimmarrëse për programin e studimit.	Institucioni nëpërmjet NJBSC dokumenton Raportet e Vlerësimit të brendshëm në mënyrë që të monitorojë ecurinë e programeve në vazhdimësi. Kjo njësi vendos raportete e vlerësimit në dispozicion të departamentit, fakultetit, rektoratit dhe senatit akademik si organe vendimmarrëse të institucionit.								
<b>Kriteri 5.</b> Raportet e vlerësimit duhet të përfshijnë rezultatet e pritshme, rezultatet e vlerësimit dhe masat e marra për adresimin e mangësive dhe përmirësimin në vijim të cilësisë.	Bazuar në RVB dhe në takimin me anëtarët e NJBSC, GVJ konstatoi se kjo njësi përgatit një raport periodik të vlerësimit të cilësisë dhe ia paraqet në formë zyrtare Rektoratit dhe Senatit Akademik. Bazuar në informacionin e pasqyruar në këtë raport institucioni merr masat e nevojshme për adresimin e mangësive të konstatuara dhe përmirësimin në vijim të cilësisë. <i>(Ref: Aneks 37)</i>								
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<table border="1"> <thead> <tr> <th></th> <th>Përmbushet pjesërisht</th> <th>Përmbushet kryesisht</th> <th>Përmbushet plotësisht</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td></td> <td></td> <td></td> <td>X</td> </tr> </tbody> </table>		Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht				X
	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht						
			X						


### Standardi VI.3

**Institucioni përdor procedura e metodologji vlerësimi, instrumente matëse dhe vlerësuese për hapjen, zhvillimin dhe ecurinë e programeve të studimit, diplomimin dhe daljen në tregun e punës apo studimeve të mëtejshme të studentëve**

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<b>Kriteri 1.</b> Vlerësimi i brendshëm i programit të studimit kryhet në mënyrë periodike nga njësia e brendshme e cilësisë që lidhet me këtë program studimi. Institucioni e	GVJ konstaton se NJBSC kryen në mënyrë periodike Vlerësimin e brendshëm të programit të studimit Bachelor në Inxhinieri Ndërtimi. Ky raport përfshihet nga Institucioni në vetëvlerësimin institucional në kuadër të

përfshin këtë informacion në vetëvlerësimin institucional në kuadër të akreditimit apo të vetëvlerësimeve të brendshme periodike.	akreditimit apo të vetëvlerësimeve të brendshme periodike. (Ref: Aneks 37)			
<b>Kriteri 2.</b> Për kryerjen e vlerësimit, institucioni përdor metoda e instrumente të ndryshme, të posaçme e të përshtatshme në përputhje me natyrën dhe specifikën e fushës akademike të programit të studimit.	GVJ konstaton se institucioni përdor nje metodologji për vlerësimin e mesimdhënies te stafit akademik te bazuar ne tre komponentetë: vleresimi nga studentët i cili përben 50% te vleres kumulative, vleresimi nga koleget me 35% dhe vetevleresimi 15%. Rezultatet e vleresimit i percillen drejtuesve të cilët marrin vendimet dhe japin rekomandimet e nevojshme për përmiresimin e problematikave që mund të evidentohen gjatë këtij procesi.			
<b>Kriteri 3.</b> Institucioni, në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programit të studimit përdor metoda të drejtpërdrejta, si vlerësim i cilësisë së mesimdhënies, vlerësim të didaktikës, kurrikulës, të mësuarit, vlerësime paralele të provimeve apo detyrave të studentëve, vëzhgime në auditor gjatë kryerjes së ushtrimeve/ praktikës, testime lokale apo të standardizuara, rezultatet e arritura në testime ndërinstiucionale apo kombëtare si provimi i shtetit për profesionet e e rregulluara dhe të tjera.	Bazuar ne RVB dhe nga takimimet gjatë vizitës në institucion konstatohet se për vlerësimin e cilesisë Universiteti përdor instrumenta të ndryshme si: • vlerësimin e cilësisë së mesimdhënies nga Drejtuesi i Departamentit dhe Dekani i Fakultetit, bazuar në tre komponentët e sipërpërmendur; • vlerësimin e kurrikulës- me anë të NJBSC • vlerësime paralele të provimeve- realizuar nga ekspertët e programeve të studimit, të caktuar nga fakulteti përkatës, për të vlerësuar cilësinë e provimeve. • vëzhgime në auditor (në raste specifike), etj.			
<b>Kriteri 4.</b> Institucioni, në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programit të studimit përdor metoda e instrumente të tërthorta vlerësimi si sondazhe e intervista të studentëve, të atyre të diplomuara (alumni), të personelit akademik, ndihmësakademik e administrativ, punëdhënësit e institucionet që bashkëpunojnë në realizimin e programit të studimit dhe palëve të tjera që përfshihen në realizimin apo që shërbejnë për vlerësimin e dijeve e kompetencave të përfuara nga ky program.	Krahas metodave të mesipërme të drejtpërdrejta institucioni përdor dhe metoda të tërthorta. Ky bejnë pjesë takime me studentët dhe marrja e mendimeve të tyre ne lidhje me çështje specifike apo te mbarëvajtjes të përgjithshme, pjesëmarrje në mbrojtjen e tezave, ndjekjen e ecurisë së studentëve, punësimin, opinionet e tyre mbi rezultatet e të nxëniet dhe orientimit në tregun e punës, takime me të diplomuar etj.			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	Përmbushet plotësisht	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht <b>X</b>







**Standardi VI.4**

**Institucioni i arsimit të lartë përfshin njësitë akademike, personelin e studentët në proceset e SBC-së të programeve të studimit dhe informon palët e interesuara në lidhje me rezultatet dhe masat e marra në vijim të tyre**

<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni duhet të parashikojë dhe garantojë në politikat dhe procedurat e brendshme të cilësisë përfshirjen e aktorëve të brendshëm dhe të jashtëm të interesuar për sigurimin dhe përmirësimin e vazhduar të cilësisë së programit të studimit.	Nga shqyrtimi i strukturës dhe dokumentacionit të Sistemit e Brendshëm të Sigurimit të Cilësisë, u konstatua se institucioni ka ngritur mekanizmat e mjaftueshme, me përfaqësues anëtarësh të brendshëm dhe të jashtëm. Njësia e Brendshme për Sigurimin e Cilësisë është përgjegjëse për hartimin e politikave dhe procedurave për sigurimin e brendshëm të cilësisë, akte të cilat miratohen nga Senati Akademik. NJBSC përbëhet nga të 9 anëtarë, mes të cilëve një Kryetari i cili anëtar i stafit akademik me kohë të plotë pa detyra drejtuese, anëtarë të stafit administrativ, përfaqësues të të diplomuarve të Universitetit, si dhe një specialist i jashtëm me përvojë në çështjet e sigurimit të cilësisë dhe student dhe përfaqësues të industrisë.
<b>Kriteri 2.</b> Institucioni përcakton përgjegjësi dhe detyra konkrete për njësitë, individët, studentët dhe palë të tjera të angazhuara në sigurimin e brendshëm të cilësisë së programit të studimit dhe garanton ushtrimin me përgjegjësi të këtyre detyrave.	GVJ konstaton se Institucioni përcakton përgjegjësi dhe detyra konkrete për njësitë, individët, studentët dhe palë të tjera të angazhuara në NJBSC dhe garanton ushtrimin me përgjegjësi të këtyre detyrave si me poshtë: 1. Kryetari të njësisë, 2. Anëtari i nga stafi akademi më me eksperiencë në këtë fushë, 3. Anëtari përgjegjës i vlerësimit të procesit mësimor nga studentët dhe vetëvlerësimi, 4 dhe 5. përfaqësues nga stafi akademik, 6. përfaqësues nga administrata 7. përfaqësues i studentëve, 8. përfaqësues nga komuniteti ALUMNI, dhe 9. përfaqësues nga industria.
<b>Kriteri 3.</b> Në vlerësimin dhe sigurimin e cilësisë së programit të studimit duhet të garantohet përfshirja e njësisë bazë dhe kryesore, përgjegjëse për programin e studimit, anëtarët e personelit akademik, ndihmësakademik e administrative dhe studentët e programit të studimit.	Gjate takimit me drejtuesit dhe me stafin e programit të studimit GVJ konstatoi se Departamenti, si njësia bazë, është përgjegjëse për mirë funksionimin dhe sigurimin e brendshëm të cilësisë së programeve përkatëse të studimit. Konstatohet se përgjegjësi i programit të studimit, personeli akademik e administrative, si dhe studentët e programit të studimit janë të përfshirë në vlerësimin dhe sigurimin e brendshëm të cilësisë.
<b>Kriteri 4.</b> Përfshirja dhe aktivizimi i aktorëve të brendshëm në proceset ciklike të vlerësimit duhet të respektojë integritetin akademik dhe të shmangë çdo lloj diskriminimi apo pabarazie	GVJ konstaton se institucioni është i angazhuar për të garantuar integritetin akademik dhe barazinë kundrejt personelit dhe studentëve. Senati Akademik i Universitetit është struktura që vlerëson, garanton dhe është përgjegjës për sigurimin e cilësisë në institucion, në përputhje me


Adresa: "Rruga e Durrësit", Nr. 219 Tiranë

E-mail: info@ascal.al

Tel: +355 (04) 22-43423

Web site: [www.ascal.al](http://www.ascal.al)

Faqe 65



kundrejt personelit dhe studentëve.	integritetin akademik duke shmangur cdo lloj diskriminimi apo pabarazie kundrejt personelit dhe studentëve.			
<b>Kriteri 5.</b> Pjesë aktive e proceseve të vlerësimit dhe sigurimit të brendshëm të cilësisë duhet të bëhen edhe bashkëpunëtorë dhe/ose ekspertë të jashtëm që kanë lidhje me programin e studimit apo mund të japin ekspertizë e mendime ekspertize të vyera në lidhje me cilësinë e programit dhe përmirësimin e saj.	Sikurse u shpreh dhe ne kriterin 2 pjesë e NJBSC janë dhe 2 anëtarë, bashkëpunëtorë të jashtëm, njëri prej të cilëve është përfaqësues nga komuniteti i të diplomuarve nga Universiteti POLIS dhe tjetri përfaqësues nga industria apo biznesi. Këta bashkëpunëtorë të jashtëm japin ekspertizë të vyera në lidhje me cilësinë e programit dhe përmirësimin e saj.			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Plotësisht përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				X


### Standardi VI.5

**Politikat, proceset dhe veprimtaritë për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë për programin e studimit, duhet të jenë publike, transparente dhe efektive, dhe të synojnë krijimin e Kulturës së Brendshme të Cilësisë**

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<b>Kriteri 1.</b> Politika, strategjia, organizimi dhe veprimtaritë në kuadër të sistemit të Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë për programin e studimit janë transparente dhe bëhen publike për studentët dhe të gjithë të interesuarit.	GVJ konstaton se Institucioni, nepermjet NJBSC është i angazhuar në sigurimi i cilësisë së programit të studimit. Kjo njësi mbulon jo vetëm procesin e mësimit, por edhe funksionet kërkimore dhe administrative. Gjetjet e raporteve të NJBSC-së në lidhje me cilësinë institucioni i bën transparente për studentët dhe të gjithë të interesuarit dhe i vë në dispozicion të Senatit Akademik. Mbledhja e senatit organizohet si mbledhje e hapur për të gjithë stafin dhe përfaqësuesit e studentëve.
<b>Kriteri 2.</b> Institucioni publikon rezultatet e vlerësimeve të programit të studimit, duke respektuar lirinë dhe etikën akademike, si dhe legjislacionin për të dhënat personale.	Nga takimet me stafin akademik të programit të studimit Bachelor në Inxhinieri Ndërtimi GVJ konstatoi se stafi ndjehet komod me mekanizmat e vlerësimit të përdorur nga Institucioni dhe shprehen respektin lirinë dhe etikën akademike, si dhe legjislacionin për të dhënat personale.
<b>Kriteri 3.</b> Rezultatet e vlerësimit duhet të shoqërohen me një plan masash, që adresojnë dhe synojnë përmirësimin e mangësive e dobësive të evidentuara.	Analiza e departamentit është e bashkangjitur në shtojcat e RVB. Forma e Planit të Veprimit hartohet nga Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë për të adresuar rekomandimet nga Bordi i Akreditimit dhe përfshin afatet kohore për plotësimin e secilit rekomandim. Gjithashtu, njësitë administrative dhe akademike përgatisin plane veprimi në përgjigje të gjetjeve të kontrollit të brendshëm të Universitetit.

	<i>(Ref: Aneks 38)</i>			
<b>Kriteri 4.</b> Institucioni vlerëson dhe siguron efektivitetin dhe impaktin e veprimtarive në kuadër të monitorimit e vlerësimit të cilësisë, në përmirësimin në vijim të cilësisë së programit të studimit.	Politikat dhe Procedurat e Sigurimit të Cilësisë janë zyrtarisht të miratuara, të dokumentuara dhe janë rishikuar dhe zhvilluar si përgjigje ndaj ndryshimeve kombëtare dhe ndërkombëtare me synim përmirësimin e vazhdueshëm.			
<b>Kriteri 5.</b> Institucioni organizon veprimtari periodike me personelin dhe studentët për informimin dhe ndërgjegjësimin e tyre për sigurimin dhe përmirësimin afatgjatë të cilësisë së programit të studimit.	Njësia e Brendshme e Sigurimit të Cilësisë, në bashkëpunim me fakultetet, organizon seanca informimi për studentët në lidhje me rëndësinë e rezultateve të vlerësimit të pedagogut të lëndës për përmirësimin e programit të studimit.			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				<b>X</b>

<b>Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës VI</b>	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				<b>X</b>



## **Përfundime të Vlerësimit të programit të studimit të ciklit të parë në Programin e studimit Bachelor në Inxhinieri Ndërtimi të Universitetit POLIS**

### **Pika të dhe afirmime:**

1. Programi i studimeve Bachelor në "Inxhinieri Ndërtimi" ofrohet nga Universiteti POLIS, i cili ka një imazh shumë të mirë në tregun e arsimit të lartë, kryesisht të fokusuar në shkencat e ndërtimit, me një organizim institucional në nivele shumë të larta.
2. Drejtuesit e të gjithë piramidës akademike dhe administrative të institucionit janë shumë të aftë dhe të përkushtuar.
3. Anëtarësimi i programit të studimit Bachelor në Inxhinieri Ndërtimi në Rrjetin Europian të Shkollave të Inxhinierisë së Ndërtimit EUCEET i jep një perspektivë dhe përvijë të mirë europiane, e cila ka ndihmuar njohjen e plotë të diplomave dhe transferimin e studimeve jashtë vendit.
4. Programi ka një personel të përkushtuar, të mirëpërgatitur dhe me një komunikim shumë të mirë me studentët, të cilët ndjehen të përfshirë në rritjen e cilësisë të programit dhe të vlerësuar nga stafi në shërbim të programit. Studentët rrezatojnë besim te institucioni dhe ndjehen të mbështetur e të orientuar drejt nga Universiteti Polis në rrugën e tyre të formimit profesional e njerëzor.
5. Universiteti POLIS vë në shërbim të stafit dhe studentëve të këtij program studimi ambiente cilësore dhe të pajisura me teknologji bashkëkohore, të cilat janë një mbështetje shume e madhe në rritjen e cilësisë të programit.
6. Universiteti POLIS bën përpjekje maksimale për promovimin e stafit akademik me synimin e marrjes së gradave dhe titujve shkencorë. Pjesëmarrja në një sërë projektesh ndërkombëtare ndihmon stafin, në shërbim të programit, të përfitojë eksperiencë ndërkombëtare dhe t'ua përcjellë atë studentëve.
7. Komunikimi i vazhdueshëm me rrjetin e alumni të Universitetit POLIS dhe me kompani që operojne në fushën e ndërtimit rezultojnë të jenë faktorë shumë pozitiv në trainimin e studentëve dhe punësimin e tyre pas diplomimit.
8. Universiteti ofron një bibliotekë të pasur me mbi 10000 libra fizikë dhe abonimin në dy platforma online.
9. Bashkëpunimi me programet e Arkitekturës dhe Dizajnit Urban është një vlerë e shtuar për programin e Inxhinierisë së Ndërtimit, që i mundëson studentëve një përfaqje më gjithëpërfshirëse ndaj problematikave profesionale.

### **Pika të dobëta/pika për përmirësim të mëtejshëm:**

1. Zgjerimi i rrjetit aktual të laboratorëve me një laborator të testimit të materialeve të ndërtimit do të ishte një kontribut shumë i rëndësishëm në rritjen e mëtejshme të cilësisë së programit.

### **Rekomandime:**


Adresa: "Rruga e Durrësit", Nr. 219 Tiranë

E-mail: [info@ascal.al](mailto:info@ascal.al)

Tel: +355 (04) 22-43423

Web site: [www.ascal.al](http://www.ascal.al)

Faqe 68



1. Krijta e mētejshme e kapaciteteve laboratorike me një laborator të testimit të materialeve të ndērtimit.

### **Conclusions of the Evaluation of the first cycle study program in the Bachelor of Civil Engineering Study Program of POLIS University**

#### **Strengths and Affirmations:**

1. The Bachelor studies program in "Civil Engineering" is offered by POLIS University, which has a very good image in the higher education market, mainly focused on construction sciences, with an institutional organization at very high levels.
2. The leaders of the entire academic and administrative pyramid of the institution are very capable and dedicated.
3. The membership of the Bachelor of Civil Engineering study program in the European Network of Civil Engineering Schools EUCEET gives it a good European perspective and experience, which has helped the full recognition of degrees and the transfer of studies abroad.
4. The program has a dedicated, well-prepared staff with a very good communication with the students, who feel involved in increasing the quality of the program and appreciated by the staff serving the program. Students radiate confidence in the institution and who feel supported and guided by Polis University in their path of professional and human formation.
5. POLIS University puts at the service of the staff and students of this study program quality facilities equipped with modern technology, which are a great support in increasing the quality of the program.
6. POLIS University makes maximum efforts for the promotion of academic staff with the aim of obtaining degrees and scientific titles. Participation in a series of international projects helps the staff, in the service of the program, to gain international experience and convey it to the students.
7. Continuous communication with the alumni network of POLIS University and with companies operating in the field of construction turn out to be very positive factors in the training of students and their employment after graduation.
8. The university offers a rich library with over 10,000 physical books and subscriptions on two online platforms.
9. Cooperation with Architecture and Urban Design programs is an added value for the Civil Engineering program, which enables students to have a more comprehensive approach to professional issues.

#### **Weak points/points for further improvement:**

1. Expanding the current network of laboratories with a building materials testing laboratory would be a very important contribution to further increasing the quality of the program.

#### **Recommendations:**


Adresa: "Rruga e Durrēsit", Nr. 219 Tiranē

E-mail: info@ascal.al

Tel:+355 (04) 22-43423

Web site: [www.ascal.al](http://www.ascal.al)

Page 69



1. Further increase of laboratory capacities with a building materials testing laboratory.

**Shkalla e përmbushjes së standardeve të cilësisë së programit**

FUSHAT E VLERËSIMIT	SHKALLA E PËRMBUSHJES SË STANDARDEVE TË FUSHËS			
	Niveli i përmbushjes	Përmbushen pjesërisht	Përmbushen kryesisht	Përmbushen plotësisht
I. OFRIMI, ORGANIZIMI DHE DREJTIMI I PROGRAMIT/EVE TË STUDIMIT				X
II. STRUKTURA DHE PËRMBAJTJA E PROGRAMIT/EVE TË STUDIMIT				X
III. MËSIMDHËNIA, MËSIMNXËNIA, VLERËSIMI DHE KOMPETENCAT				X
IV. BURIMET PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT				X
V. STUDENTËT DHE MBËSHTETJA E TYRE				X
VI. SIGURIMI I CILËSISË SË PROGRAMIT/EVE				X
<b>VLERËSIMI TËRËSOR</b>				<b>X</b>

